



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi
Shqipe”**

Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Asoc. Albana Deda (Ndoja)

Dr. Ardita Dylgjeri

Shkurt / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Shqipe Departamenti i Letërsisë Shqipe
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr.4271/1 Prot, datë 05.08.1986
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH Nr. 334, datë 13.7.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ETCS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a. 2020-2021 5 studentë v.a. 2021-2022 6 studentë v.a. 2020-2021 14 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Më 13 dhe me 14 nëntor 2023, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi vizitën në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë për vlerësimin e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Vlerësimi i këtij programi studimi bëhet për herë të parë nga ASCAL-i.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" ofrohet pranë Njesisë Bazë të Gjuhës Shqipe dhe Njesisë Bazë të Letërsisë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë. Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 414, më 12 Nëntor 1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik, që ishte çelur më 1971.

Në vitin 1969 u hap Instituti Pedagogjik 2-vjeçar pa shkëputje nga puna për përgatitjen e mësuesve, midis të tjerave, dhe për specialitetin Gjuhë – Letërsi. Me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 255, datë 24.07.1986, u hap Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Deri në vitin 2010, stafi akademik ka qenë i organizuar në një departament, me emërtesën "Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë". Me vendim të Senatit Akademik, datë 16.03.2010, u bë riorganizimi i departamentit, i cili u nda në dy departamente: Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Departamenti i Letërsisë. Deri në vitin 2008 programi i studimit ka qenë 4-vjeçar për sistemin me kohë të plotë dhe 5-vjeçar për sistemin me kohë të pjesshme. Me reformimin e Arsimit të Lartë në Shqipëri, sipas Procesit të Bolonjës dhe reformimit të programeve të studimit, kohëzgjatja u bë 3 vite akademike me 180 kredite. Programi i studimit nga emërtimi "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", në vitin 2008-2009, më vonë, pas ndryshimeve të akteve ligjore u emërtua Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".

Programi i studimit është ndërtuar, duke pasur parasysh kreditet vjetore që duhet të fitojë një student dhe orët vjetore të programuara, përkatësisht, 60 kredite në vit dhe 1500 orë në vit. Pas konsultimit të dosjes së paraqitur në ASCAL, duhet të themi se është bërë një punë e përgjegjshme dhe serioze për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, për grumbullimin e të dhënave të bollshme në shërbim të vlerësimit për akreditimin e programit. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitet dhe qartësi dhe me përpjekje që të pasqyrohen me vërtetësi gjendja aktuale e cilësisë së programit të studimit, stafit akademik dhe atij administrativ, si dhe të infrastrukturës mbështetëse. RVB-ja është ndërtuar duke përdorur burime të nevojshme, duke e mbështetur çdo pohim në shkresën përkatëse që disponon DGJ dhe DLG, si dhe duke përdorur drejt terminologjinë e fushës së vlerësimit të cilësisë.

Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Senatit Akademik dhe Rektoratit të Universitetit "Eqrem Çabej", të Gjirokastrës. Disiplinat gjuhësore dhe letrare që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me silabuse dhe ngarkesa në ETC. GVJ vërejtë se ky program studimi mbulohet njëherazi nga dy departamente, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Departamenti i Letërsisë. Departamentet pjesë e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë kanë në përbërje staf akademik



me përvojë dhe të kualifikuar, që i përballon mirë kërkesat shkencore që shtron ky program studimi.

GVJ-ja vërejtë se stafi akademik duhet të përfshihet dhe të mbështet institucionalisht më shumë në projekte e trajnime ndërkombëtare. Sfidë e departamenteve është ndërkombëtarizimi i tyre nëpërmjet programeve, projekteve e trajnimeve me departamentet simotra në nivel ndërkombëtar.

Po kështu, problematika kryesore që duhet të zgjidhin në të ardhmen këto departamente është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi. Kemi parasysh se në vitin akademik 2022-2023 janë regjistruar 14 studentë në vit të parë. Në vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar 6 studentë dhe në vitin akademik 2020-2021 janë regjistruar 5 studentë dhe 1 tjetër i transferuar ndër breza. Në total numri i studentëve shkon në 26. Ky është një problem i cili ndërthur shumë arsye dhe aktorë dhe që prek jo vetëm këtë departament, por të gjitha departamentet që ofrojnë programe studimi në mesuesi në universitetet rajonale. Si rrjedhojë prej UGJ-së, Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ku bën pjesë këto departamente, duhen hartuar politika më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për të rritur numrin e studentëve.

Megjithëse pas zhvillimit të këtij programi studimi, Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, studenti i ka të pakta mundësitë e punësimit DGj/DLG, si dhe strukturat përkatëse të UGJ-së, duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (alumni) dhe të krijojnë databazën e alumnit edhe në nivel departamenti.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhej nga Prof. As. Dr. Albana Deda (Ndoja), Dr. Ardita Dylgjeri, si dhe nga përfaqësuesja e ASCAL, Msc. Aleksandra Xhamo.

Grupi studioi me shumë kujdes Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Departamentit të Gjuhësisë dhe Departamentit të Letërsisë, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, për t'u njohur paraprakisht me gjendjen dhe problematikën e programit. Bazuar në këtë informacion, u hartua një draft paraprak i raportit të GVJ-së, shoqëruar me një seri pyetjesh që lindën gjatë studimit të tij. Gjatë vizitës dy ditore (13 dhe 14 nëntor 2023) pranë dy njësive që mbulojnë programin, pyetjet në fjalë iu adresuan personave përgjegjës. Përgjigjet e marra u bënë pjesë e dokumentit final të këtij raporti. Gjatë vizitës në IAL, GVJ mori kontakte dhe bisedoi me personat e poshtëshënuar;

Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane;

Përgjegjësin e departamentit të GjS;

Përgjegjësin e departamentit të GjL;

Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit;

Stafin akademik të Departamentit të Gjuhës Shqipe;

Stafin akademik të Departamentit të Letërsisë;

Përfaqësues të Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave;

Përfaqësues të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë;

Përfaqësues të Sektorit të Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore;

Përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative;

Studentë të programit të studimit nga tri vitet akademike;

Sekretarinë mësimore;

Përfaqësues të Bibliotekës;

GVJ vizitoi mjediset e mësimi dhe aktivitetit tjetër studentor në IAL (auditorë, laboratorë, biblioteka). Ky raport pasqyron përmbledhtazi mendimet tona për programin. Ndonëse në tërësinë e vet raporti ynë konfirmon gjetjet kryesore të RVB-së, ndan edhe qëndrime të ndryshme prej tij lidhur me aspekte të caktuara të gjendjes dhe shkallës së plotësimit të standardeve të cilësisë së programit.



Më datë 05.02.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 85/1 Prot., datë 05.02.2024, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 13.02.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 209/2 Prot., datë 12.02.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

Pasi shqyrtuam komentet e ardhura nga institucioni ne si ekspertë të jashtëm konkludojmë që institucioni është i dakortësuar me draft raportin e vlerësimit të jashtëm (DRVJ) prandaj gjykojmë që ky draft dërgohet tani nga ana jonë si Raport i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, si dhe nga vizita në Universitetin "Eqrem Çabej" të Gjirokastrës, konstatohet se ky Universitet ka paraqitur për akreditim këtë program studimi (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe), i cili me përmbajtjen e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Po kështu, nga analiza e hollësishme e tij vërejmë se ky program studimi synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky program studimi është gjithashtu në përputhje me vizionin e arsimit të lartë, të shprehur në Ligjin e Lartë përkatës nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Ai u shërben interesave kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Pohimet më lart u referohen dokumentacionit vijues: Evidenca 1.1. Statuti i UGJ-së, neni 2, neni 4, neni 5, neni 8; Evidenca 1.2. Strategjia e zhvillimit në UGJ-së, fq. 8-10; Evidenca 1.3. Vendimi i FESHSH-së, nr. 5, datë 19.12.2019, për miratimin e planit strategjik të zhvillimit të FESHSH-së; Evidenca 1.3.1 Planit strategjik i zhvillimit të FESHSH-së, 2020-2025, fq. 8-11;
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit vlerësojmë se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" i paraqitur nga FESHSH-ja e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin, si dhe fushën e veprimtarisë së parashikuar dhe në dokumentacionin bashkangjitur: Evidenca 1.1. Statuti i UGJ-së, neni 4, neni 5, neni 8; Evidenca 1.2. Strategjia e zhvillimit të UGJ-së, 2020-2025, fq. 8-10; Evidenca 1.3.1 Planit strategjik i zhvillimit të FESHSH-së, 2020-2025, fq. 8-11;

	Po kështu ky program është në përputhje me misionin dhe qëllimin e njësive bazë të gjuhës shqipe dhe njësive bazë të letërsisë. Evidenca 1.4. Plani strategjik i zhvillimit të njësive bazë të gjuhës shqipe, fq. 4; Evidenca1. 5. Plani strategjik i zhvillimit të njësive bazë të letërsisë, fq.4. Evidenca1. 6. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, fq. 2.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit, si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Konstatohet se programi Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” nuk bie në kundërshtim, po është në përshtatje edhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UGJ-së, të FESHSH-së dhe strategjive të zhvillimit të njësive bazë përkatëse, të Statutit të UGJ-së dhe rregullores së UGJ-së, të FESHSH-së dhe të njësive bazë përkatëse, si dhe me fushat e drejtimeve të tyre akademike (me fushën e gjuhësisë, të albanologjisë, të studimeve letrare në fushën e letërsisë shqipe dhe asaj botërore). Evidenca1.1 Statuti i UGJ-së, neni 62, neni 63, neni 65; Evidenca 1.2 Strategjia e zhvillimit të UGJ-së, q.8-10; Evidenca1. 7. Rregullore e Universitetit "E. Çabej", neni 42, neni 46, neni 48; . Evidenca1. 6. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, f. 2.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga dokumentacioni që gjendet në RVB konstatohet se njësia bazë e gjuhës dhe njësia bazë e letërsisë përbëhen nga një staf akademik me përvojë dhe tituj akademikë, me veprimtari kërkimore adekuate në fushat, që lidhen me këtë program: Gjuhësi dhe Letërsi. Konstatohet se stafi aktual akademik i dy njësive bazë të gjuhës dhe të letërsisë që jep mësim në këtë program studimi ka në përbërje 3 Profesorë të Asociuar, 9 doktorë dhe 3 anëtarë me master. Ajo që mund të thuhet në këtë kontekst, pasi kemi parë dhe vitet, kur janë marrë titujt përkatës, si dhe problematikat e ndryshimet e shpeshta të legjislacionit përkatës, është se pavarësisht se ka përpjekje në marrjen e titujve të rinj (kujtojmë se kemi 2 tituj doktor të marrë në 2020 dhe 2021), <i>përsëri është e nevojshme që ky numër të jetë edhe më i madh.</i> Natyrisht është e kuptueshme se një pengesë në këtë proces kanë qenë pengesat në plotësimin e akteve normative përkatëse, po vihet re një diferencë e madhe kohore e marrjes së një titulli nga ai paraprirës (Kështu nuk ka asnjë lëvizje që nga 2016, kur është marrë titulli i fundit profesor i asociuar për marrjen e titullit profesor. Dy personat me titullin

	master datojnë që nga 2011 njëra dhe 2013 tjetra. Më mirë paraqitet situata te titulli doktor. Evidenca 1.8. Vendim nr.55,datë 16.12.2021, Për akreditimin periodik të IAL, universiteti “E. Çabej”, Gjirokastrë; Evidenca 1.9. Vendim NR.823,DATË 5.12.2007, Për krijimin e disa njësive kryesore, Fakulteteve të universitetit “E. Çabej”, Gjirokastrë; Evidenca 1.10. Vendim i hapjes së degës Gjuhë -letërsi; Evidenca 1.10.1 Udhëzimi nr.16.datë 2.6.2009, Për kriteret e organizimit të formave të studimit në IAL. Evidenca 1.11. Vendimi nr. 4,datë 8.1.1971, Për hapjen e ILP-së, Gjirokastrë; Evidenca 1.12. Vendimi nr.414,datë 12.11.1991, Mbi krijimin e Universitetit “E. Çabej”, Gjirokastrë. <i>Mund të shtohet këtu edhe shkresa me nr. 210 ku gjenden CV e stafit akademik.</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Konstatohet se njësia bazë e gjuhës dhe njësia bazë e letërsisë janë njësi bazë të FESHSH-së, të cilat ofrojnë programe studimi në fushë të gjuhësisë, albanologjisë, fushave ndërdisiplinore (sociolinguistikë, pragmatistikë, gjuhësi teksti etj.) dhe në fushë të studimeve letrare, të historiografisë së letërsisë shqiptare dhe asaj botërore. Po kështu vërejmë se programi Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” shfaqet në përputhje me fushat akademike e kërkimore të FESHSH-së dhe të njësive bazë përkatëse. Diploma i përket nivelit 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve (KSHK), ciklit të parë të studimeve universitare, me numrin unik të identifikimit 000344 në regjistrin e diplomave të regjistruara në MASH. Njësia bazë e gjuhës shqipe dhe njësia bazë e letërsisë, bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Nenet 5, 63; Evidenca 1.13 Urdhëri i QSHA-së,nr.202,datë 9.4.2010, Për regjistrimin e formës së diplomave të nivelit të parë të universitetit “E. Çabej”, Gjirokastrë; Evidenca 1.14, nr. 334,datë 13.7.2011 Urdhër për regjistrimin e formës së diplomave “Bachelor” të universitetit “E. Çabej”,

	Gjirokastrë. Evidenca 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FESHSH-së, 2020-2025, fq.21-22. Evidenca 1.15 Shkresa e Rektorit nr. 343, datë 16.03.2023, Dërgimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të studimit që ofron universiteti "E. Çabej"; Evidenca 1.15.1 Propozimet e FESHSH-së për kodifikimin e programeve; Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programit Bachelor" në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës në lidhje me standardin I.1 GVJ-ja shohim se programi i paraqitur për shqyrtim është hartuar për të mos rënë ndesh me interesat kombëtare dhe ruajtjen e vlerave akademike shkencore. Ai shfaqet në përputhje të plotë në lidhje me qëllimet dhe llojin e veprimtarisë me të cilën merret.</i> <i>Gjithashtu ky program shfaqet në përputhje me strategjinë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit, si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij. Programi ofron përvojën dhe kapacitetet e nevojshme akademike dhe infrastrukturore, pavarësisht se gjithnjë ka vend për përmirësim. Kështu, mirë do të ishte që të shpejtohej procesi i marrjes së titujve të rinj nga shgumica e stafit akademik, si shenjë kjo dhe e rritjes së kualifikimit personal, po dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Edhe në lidhje me literaturën bazë të moduleve specifike mëndojmë se duhet punuar që ajo të reflektojë studimet më të fundit në fusha përkatëse. Kjo mund të shfrytëzohet në lëndë që mund të përdoren literatura të huaja si bazë metodologjike dhe që mund të konspektohen e t'u jepen studentëve nga titullari i tyre (Vërejmë se teksti bazë në përdorim në jo pak lëndë është pothuajse i 20 viteve më parë dhe mbi të gjitha është e vetmja alternativë konsultimi).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në lidhje me këtë kriter vërejmë se aktet normative të brendshme sigurojnë që veprimtaria e UGJ-së të drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj, me kompetenca të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, në Statutin, në Rregulloren dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit. Nuk shkohim konflikt apo konfrontim mes kompetencave të njësive bazë, apo dhe të tjerave në lidhje me këtë kriter. Rregulloret përkatëse përgjithësisht janë hartuar në frymën jo vetëm të ligjit të sipërpërmendur, po dhe përvojave tashmë të njohura të institucioneve homologe. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, kreu II, III, IV, dhe V; Evidenca 1.7 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”; Gjirokastrë, Kreu II, III, IV dhe V; Evidenca 1.18 Struktura organizative e UGJ-së; Evidenca 1.19 Struktura organizative e FESHSH-së. Shohim që në lidhje me veprimtarinë akademike janë kërkuar raportime periodike dhe këto të fundit janë pasqyruar në raportet përkatëse. Evidenca 1.16 Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.17 Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; Shtojmë se janë njësitë bazë që bashkëpunojnë dhe mbikëqyrin mbarëvajtjen dhe aplikimin korrekt të këtij programi. Në këtë proces këtyre njësive u bashkohen dhe instancat e tjera të parashikuara nga rregulloret dhe statuti për mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie. Anekse. Tabela përmbledhëse. Tabelat 6.1; 6.2; 6.3;
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga verifikimi i dokumentacionit, veprimtarive të organizuara, si dhe mobiliteteve akademike konstatohet se Universiteti "E. Çabej" ka përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të tij institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit. Në dokumentacionin e dorëzuar në dosje gjenden marrëveshje bashkëpunimi të ndryshme me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Një praktikë e tillë shton mundësinë e shkëmbimeve akademike me përfitim të dy palëve, po ashtu edhe të studentëve. Në këtë mënyrë ky program bëhet më tërheqës për këta të fundit. Po kështu, krijohen mundësi



	alternative për njohjen dhe përfitimin në integrimin e tregut të punës nga ana e studentëve. Evidenca 1.2. Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, 2020-2025, Lidhjet komunitare dhe kombëtare fq.31, Roli Ndërkombëtar f. 32; Evidenca 1.2.1. Strategjia e ndërkombëtarizimit të UGJ-së. Evidenca 1.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve, mobiliteteve; Evidenca 1.16. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik, 2021-2022. <i>Gjithësesi duhet të shtojmë se këto lloj aktiviteteve mbeten më shumë në kuadrin e marrëveshjeve të shkruara. Po kështu edhe binjakëzimet dhe mobilitetet akademike e administrative kanë shumë nevojë për përmirësim. Mbeten të kufizuara nga pikëpamja e krijimit dhe aplikimit konkret edhe marrëdhëniet me biznesin apo institucionet të ndryshme qeveritare ose jo që mund të jenë pjesë e praktikave, ose aktualizimit të njohurive që marrin studentët në auditor.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Në RVB-në e paraqitur theksohet se programi Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” në planin mësimor nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale. Gjykojmë se një pohim i tillë hedh poshtë kriterin paraprirës, ku theksohen marrëveshjet e nënshkruara dhe këto mund të shihen si një mundësi e mirë e praktikimit të njohurive.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në RVB-në e paraqitur theksohet se Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” në planin mësimor nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale. Gjykojmë se një pohim i tillë hedh poshtë kriterin 2, ku theksohen marrëveshjet e nënshkruara dhe këto mund të shihen si një mundësi e mirë e praktikimit të njohurive. Besojmë se me termin “praktikë” nuk duhet konceptuar vetëm mësimdhënia, që realizohet më pas në master, po edhe aktivitete të ndryshme në bachelor. Në këtë kuadër mund të shfrytëzohen dhe t’ju quhen në vlerësim ato aktivitete që parashikohen nga përshkrimi i kriterit 2 më lart.
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në UGJ GVJ-ja vlerëson se standardi I.2 përmbushet pjesërisht.</i>

	Po kështu, në statut dhe dokumente të tjera parashikohen prioritete që lidhen qartë me strategjinë e zhvillimit të tij institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit. Këto prioritete reflektohen në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto marrëveshje sigurojnë marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ku përfitues janë studentët dhe personeli akademik. Aktivitetet pasqyrohen dhe në raportet institucionale vjetore. Nga ana tjetër në kriterin 3 dhe 4 të këtij standardi theksohet mungesa e praktikave mësimore. Një fakt i tillë vë në pikëpyetje prioritetet me përmendura në kriterin 1, si dhe marrëveshjet e ndryshme me institucione homologe dhe jo vetëm që paraqiten në dokumentacion. Besojmë se me termin "praktikë" nuk duhet konceptuar vetëm mësimdhënia, që realizohet më pas në master, po edhe aktivitete të ndryshme në bachelor. Në këtë kuadër mund të shfrytëzohen dhe t'ju quhen në vlerësim ato aktivitete që presupozohen nga përshkrimi i kriterit 2 më lart. Gjithsesi, mbeten të pailustruara bindshëm aplikimet konkrete të marrëveshjeve të parashikuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e	Konstatojmë se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" është i organizuar në lëndë, të cilat janë

module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	vlerësuar në kredite, bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe. Programi është organizuar në tri vite akademike, 60 kredite për çdo vit akademik, në përfundim të të cilave studenti grumbullon 180 kredite (ECTS) dhe merr diplomën universitare Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Programi përmban kategoritë e veprimtarive formuese (lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese, detyrime përmbyllëse), që karakterizojnë programin Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Evidenca 2.1. Rregullore e Studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, neni 11, pika 1; Evidenca 1.6. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", fq.2; Evidenca 2.2. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", 2021-2024; Evidenca 2.3. VKM nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca 2.3.1. VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca 2.4. VKM Nr. 185, datë 25.03.2021.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Konstatohet se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" përgatit njohës të thelluar në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë. Këto njohuri janë parashikuar të aktualizohen specifikisht në korpusin e shqipes. Përveç njohurive që mbështeten në korpusin e shqipes, këto të fundit integrohen dhe me deduktime që i takojnë korpusit të madh gjuhësor, ku përfshihen edhe kode të tjera gjuhësore, duke i pajisur studentët me njohuri më të thella mbi shkencën e gjuhësisë dhe letërsisë, që u mundësojnë qasjen me profesione dhe specialitete të ndryshme dhe të vijojnë studimet në programe studimi të ciklit të dytë për të ushtruar më tej profesione si: mësues, redaktor, punonjës në arkiva, në biblioteka si specialistë të gjuhës në radio, televizione etj. Duke pasur parasysh problematikat që shfaqen në lidhje me tregun e punës që lidhet me këtë program studimi, <i>sugjerojmë që emërtimi i ciklit të studimit të zgjerohet fushën e kompetencës, duke u emërtuar Bachelor në "Gjuhësi dhe Letërsi".</i> Në këtë mënyrë rriten mundësitë e punësimit të studentëve dhe njëkohësisht krijohet mundësia e shfrytëzimit të stafit akademik të degëve të tjera në mësimdhënie (Kemi parasysh se gjatë vizitës na u referua fakti se nuk kishin staf të mjaftueshëm akademik, pasi nuk paraqiteshin kandidatura në



	konkurset e shpalluara. Kolegët e gjuhëve të huaja mund të mbulojnë një pjesë orësh të këtij cikli, pasi e kanë kompetencën dhe mundësinë e shfrytëzimit të literaturave në gjuhë të huaj.). Evidenca 2.2. Plan mësimor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024; ANEKSE. Tabela përmbledhëse. Tabela 14. Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", është përcaktuar qartë në lidhje me veprimtaritë formuese sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite si vijon: A. Lëndë bazë (35 kredite – 19.44%; standardi përkatës 15-20%) B. Lëndë karakterizuese (99 kredite – 55%; standardi 50 – 55%); C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (22 kredite – 12.22; standardi 12 – 15%); D. Lëndë Plotësuese (18 kredite –10%; standardi 10 – 15%); E. Detyrime Përmblylëse (6 kredite – 3.33; standardi 3 – 5%); Ne kemi bashkangjitur në këto të dhëna dhe standardet e parashikuara në ligj në lidhje me këtë veprimtari janë në përgjithësi konform udhëzimeve të parashikuara . Evidenca 2.3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca 2.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca 2.4.VKM Nr. 185, datë 25.03.2021; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 23; Evidenca 2.2. Plani mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E). Tabela 9
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.	Konstatohet se programi Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" në planin mësimor të tij nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale, pasi ajo më së shumti i përket ciklit vijues të studimeve. Gjithsesi mbase duhet parë mundësia që edhe praktikat që kanë të bëjnë me mbledhjet dialktore e ltrare në kuadrin e eskpeditave, apo veprimtari të ndryshme në kuadrin e marrërvjeshjeve të nënshkruara nga institucioni të mund të parashikohen në këtë program si praktika mësimore, pasi ato

	realisht aplikohen. Nuk vërejmë ndonjë kundërshti edhe në lidhje me detyrimet përmbyllëse, pasi ato janë parashikuar sipas standardit referues. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 93, pika 1; Evidenca 2.5. Rregulloren e FESHSH-së, Neni 39,40. Evidenca 2.2. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe letërsi shqipe", 2021-2024. ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Plan i mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E). Tabela 9 <i>Sugjerohet që aktivitetet e përcaktuara në marrëveshje bashkëpunimi si me institucione homologe, ashtu edhe të tjera, të cilat kanë arritur të aplikohen t'ju indeksohen studentëve në vlerësimin e lëndëve të caktuara, ku këto veprimtari të konsiderohen si praktika mësimore në kuadrin e vlerësimit 20 % të gjithë lëndës.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga shqyrtimi i RVB- së vërejmë se procesi i organizimit forma e organizimit të studimeve, pranimi i studimeve dhe financimi i studentëve janë përcaktuar si në rregulloret përkatëse, ashtu dhe në vendime të ndryshme të referuara në fund të këtij kriteri. Në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" forma e studimit është me kohë të plotë. Format e financimit të studentëve përfshijnë financimin nëpërmjet bursave dhe nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e studimit. Financimi bëhet për dy kategori. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kriterëve të tjera të vendosura me aktet nënligjore. Në fillim të çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UGJ. Nga vizita në Universitet konstatuam aplikimin e këtyre vendimeve, si një politikë informuese e mbështetëse shumë të mirë në këtë kontekst. Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 8; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 49, Neni 61, Neni 65; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu VI; Evidenca 2.6. Vendime të Bordit të Administrimit (nr.21.datë 24.5.2021; nr. 3, datë 14.01.2022; nr. 43.datë 23.12.2020, nr.44.datë 23.12.2020);




	Evidenca 2.6.1 Vendimi i Senatit Akademik nr. 24, datë 9.9.2021; Vendimi i Rektoratit nr.07, datë 9.9.2021 për heqjen e taksës së shkollimit për aplikantët që regjistrohen në programet Bachelor.
Kriteri 6.Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Konstatohet se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" që ofrohet nga njësia bazë e gjuhës shqipe dhe njësia bazë e letërsisë është i ngjashëm me programe të tjera të studimit që ofrohen në universitetin e Tiranës, të Korçës, të Shkodrës, të Vlorës, të Durrësit. Kjo ngjashmëri ka lidhje me fushën e njëjtë të studimit (gjuhësi, albanologji dhe studime letrare). Planet mësimore janë mbështetur në legjislacionin referues (Udhëzimi i MASR-së, nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"). Evidenca 2.3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca 2.2. Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", 2021-2024. <i>Gjykojmë se sugjerimi i dhënë në kriterin 2 të këtij standardi të jetë një element që të përdoret me zgjuarsri në të mirë të përthithjes dhe rekrutimit të studentëve, pasi ky kriter (6) stimulon të kundërtën e këtij procesi, nëse kemi parasysh prirjet e zhvendosjeve demografike sot në vend.</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Konstatohet se në lidhje me këtë kërkesë të parashikuar nga ky kriter, janë ndjekur të gjitha hapat e parashikuara në ligj. Kështu, bashkangjitur gjendet shkresa e Rektorit nr. 59/1, datë 20. 01. 2023, në mbështetje të Vendimit nr. 310 datë 11.05.2022 (të Këshillit të Ministrave për "Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë") dhe udhëzimit nr. 31, datë 15. 11. 2022 të MASR-së ("Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë") pika 1, pika 2 dhe pika 12, të cilat parashikojnë dhe hapat konkrete të kryerjes së tij. Në përmbushje të këtij dokumentacioni njësia bazë e gjuhës shqipe dhe njësia bazë e letërsisë kanë depozituar pranë zyrës së kurrikulave të UGJ-së dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e aplikimit pranë MAS-it për kodifikimin e programit të studimit, në lidhje me kodin që duhet të përmbajë ky program studimi. Evidenca 2.7. MAS, Për kodifikimet e programeve të studimi, nr.59, datë 18.01.2023; Evidenca 1.15. Shkresa e Rektorit nr. 343, datë 16.03.2023, Dërgimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të studimit që ofron universiteti "E. Çabej", Gjirokastër; Evidenca 1.15.1

	Propozimet e FESHSH-së për kodifikimin e programeve; Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Në RVB në lidhje me këtë kriter gjejmë pohimin se ai nuk aplikohet. Sugjerojmë hartimi dhe aplikimi i praktikave të tilla që do të rrisnin vlerën e diplomës që do të jepej në këtë kuadër dhe njëkohësisht numrin e studentëve që sot shfaqet mjaft i reduktuar. Për këtë mund të shfrytëzohen më mirë marrëdhëniet me institucionet homologe në vend dhe të huaja, në kuadrin e ndërkombëtarizimit. Mund të shfrytëzohen në këtë aspekt përvojat e universiteteve të caktuara në vend që kanë filluar tashmë aplikimin e programeve të tilla. Të shfrytëzohen Erasmus-et, gjithashtu, për të krijuar kontakte të domosdoshme.			
Konkluzione	<i>Ky standard merret me programin e studimit dhe shihet nëse është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Vërejmë se ky program është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i> <i>Duke pasur parasysh problematikat që shfaqen në lidhje me tregun e punës, që lidhet me këtë program studimi, sugjerojmë që emërtimi i ciklit të studimit të zgjerohet fushën e kompetencës, duke u emërtuar Bachelor në "Gjuhësi dhe Letërsi".</i> <i>Në këtë mënyrë, rriten mundësitë e punësimit të studentëve dhe njëkohësisht krijohet mundësia e shfrytëzimit të stafit akademik të degëve të tjera në mësimdhënie.</i> <i>Gjithashtu, sugjerojmë që aktivitetet e përcaktuara në marrëveshje bashkëpunimi si me institucione homologe, ashtu edhe të tjera, të cilat kanë arritur të aplikohen t'ju indeksohen studentëve në vlerësimin e lëndëve të caktuara, ku këto veprimtari të konsiderohen si praktika mësimore në kuadrin e vlerësimit 20 % të gjithë lëndës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																								
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i RVB-së dhe nga vizita në Universitet pohojmë se ky institucion përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin. Kujtojmë këtu që me vendimin nr. 3, datë 16.3.2010 të Senatit Akademik të UGJ-së, nr.3, datë 16.3.2010, departamenti u nda në departamentin e gjuhës dhe departamentin e letërsisë. Njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" janë pjesë të njësisë kryesore, FESHSH-së, i cili ka në përbërjen e vet 6 njësi bazë. Njësitë bazë përgjegjëse kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik. Njësia bazë e gjuhës shqipe ka 7 (shtatë) personel akademik: Prof.asoc. 2 (dy); Doktorë 5 (pesë); 6 (gjashtë) prej tyre janë të përfshirë në mësimdhënien universitare në këtë program. Në RVB pohohet se njësia bazë e letërsisë ka në përbërjen e saj 7 (personel akademik), nga të cilët 1 (një) Prof.dr.; 1 (një) Prof.asoc.; 4 (katër) Doktorë dhe 1 (një) MSC. 1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 16 PAE dhe 0 PAK (100% PAE) 2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 16 PAE dhe 0 PAK (100% PAE) 3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 15 PAE dhe 1 PAK (93 % / 7 %) <table><tr><th>Tituj/ grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th></th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Prof.Asc.</td><td>3</td><td>0</td><td>3</td><td>0</td><td>3</td><td>0</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>7</td><td>0</td><td>9</td><td>0</td><td>9</td><td>0</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>5</td><td>0</td><td>3</td><td>0</td><td>3</td><td>1</td></tr><tr><td>MP</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Totali</td><td>16</td><td>0</td><td>16</td><td>0</td><td>15</td><td>1</td></tr></table>	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023			PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	0	1	0	0	0	Prof.Asc.	3	0	3	0	3	0	Dr./PhD.	7	0	9	0	9	0	Msc.	5	0	3	0	3	1	MP	0	0	0	0	0	0	Totali	16	0	16	0	15	1
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																				
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																			
Prof.Dr.	1	0	1	0	0	0																																																			
Prof.Asc.	3	0	3	0	3	0																																																			
Dr./PhD.	7	0	9	0	9	0																																																			
Msc.	5	0	3	0	3	1																																																			
MP	0	0	0	0	0	0																																																			
Totali	16	0	16	0	15	1																																																			

	UGJ- ja ka marrë akreditimin periodik institucional me Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. Evidenca 1.9. Vendimi nr. 823, datë 5.12.2007, Për krijimin e disa njësive kryesore, fakulteteve të universitetit "E. Çabej", Gjirokastër; Evidenca 1.10. Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës nr. 4271/1, datë 5.8.1986, Hapja e degës gjuhë-letërsi; Evidenca 2.8. Vendimi i Senatit Akademik, nr.3, datë 16.3.2010: Ndarja e departamenteve; Evidenca 2.9. Vendim Rektorati nr. 06, datë 26.3.2018, Për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019; Evidenca 2.10. Vendim nr.17, datë 8.7.2021 i Senatit Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022; Evidenca 1.1. Statuti i UGJ-së, neni 11. Evidenca 1.19. Struktura organizative e FESHSH-së; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.2 Evidenca 1.8. Vendimi nr. 55, datë 16.12.2021 të Bordit të akreditimit të ASCAL.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në RVB pohohet se nuk ka personel ndihmës-akademik. Në veprimtaritë që mund t'i kryenin këtë të fundit, angazhohet personeli akademik (ekspedita). Evidenca 2.2. Plan i mësimor i programit të studimit "Bachelor në gjuhë dhe letërsi shqipe" 2021-2024; Evidenca 2.11. Sylabusi i lëndës "Ekspeditë gjuhësore dhe folklorike" 2022-2023. <i>Një fakt i tillë kushtëzohet edhe nga gjendja financiare aktuale. Sugjerohet që me përmirësimin e kësaj të fundit të rekrutohet personel i tillë, qoftë edhe nga studentët për realizimin e veprimtarive në lidhje me studentët, por edhe projekteve në kuadrin e kërkimit shkencor të pedagogëve në fusha specifike (dialektologji, sociolinguistikë, pragmatikë, psikolinguistikë etj.).</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është	Në bazë të RVB-së dhe vizitës në universitet pohojmë se koordinatorët akademikë të programit janë drejtuesit e njësive të gjuhës dhe letërsisë. Po kështu, pedagogët, të cilët e kanë ngarkesë mësimore vjetore të planifikuara, janë njëkohësisht përgjegjës për zhvillimin e praktikës gjuhësore dhe folklorike në terren.


përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Evideca 1.7. Rregullore e UGJ-së, neni 18; Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-së, neni 11.			
Konkluzione	<i>Ky standard vlerëson nëse njësia kryesore/bazë, e cila është përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i> <i>Sugjerojmë që me përmirësimin e gjendjes financiare të Universitetit të rekrutohet personel akademik, ndihmës-akademik (qoftë edhe nga studentët për realizimin e veprimtarive në lidhje me studentët, por edhe projekteve në kuadrin e kërkimit shkencor të pedagogëve në fusha specifike dialektologji, sociolinguistikë, pragmatikë, psikolinguistikë etj.).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i RVB-së vemë re se njësitë përgjegjëse kanë pasur informacionin e nevojshëm për të hartuar programin përkatës. Referencat kryesore kanë qenë ato që kushtëzohen edhe nga standardet e kërkuara në këtë raport të tilla si: -Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; -Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, -Vendimi Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, -Vendimi Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar, me Statutin e UGJ-së

	- Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" - Rregullore e Njesisë bazë të gjuhës shqipe; Rregullore e njësisë bazë të letërsisë, neni 2/2, (Misioni dhe objektivat); - Plani mësimor të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe letërsi shqipe " - Programet (syllabuset) e lëndëve mësimore; - Modeli i diplomës Bachelor në "Gjuhë dhe letërsi shqipe" - Suplementi i diplomës; - Struktura mësimore 2022-2023; - Personeli akademik i angazhuar ne programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". (Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 65) si dhe me Rregulloren e Universitetit (Evidenca 1.7 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Evidenca 2.12. Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" Evidenca 2.2. Plan mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023. Tabela 14 Evidenca 2.13. Modeli i diplomes Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe"; Aktet e miratimit; Evidenca 2.14 Model suplementi të diplomës, Vendim nr. 16.datë 8.7.2021; Evidenca 2.15. Struktura Mësimore Bachelor në " Gjuhë dhe Letërsi Shqipe"; ANEKS. Tabelat përmbledhëse. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit. Tabelat 6.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" përmban planin mësimor, ku përfshihet gjithë informacioni i nevojshëm (Format e veprimtarive mësimore, numri i javëve mësimore sipas semestrave, numri total i provimeve sipas semestrave; ndarja e lëndëve mësimore sipas viteve dhe semestrave; ndarja e lëndëve mësimore sipas aktiviteteve formuese; ngarkesa në kredite, numrin total të orëve, numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe orëve në javë; komponentet mësimore për secilën lëndë; forma e vlerësimit.) Evidenca 2.2. Plani mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024;



Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në RVB theksohet se studentëve u ofrohet asistencë e duhur informuese në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit apo ekuivalentimit të studimeve. Nga vizita në Universitet dhe takimi me studentët na u vërtetua pohimi i mësipërm, pasi ata ishin të ambientuar me dokumentacionin lidhur me këtë kriter (Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 49, Neni 61, Neni 65; Rregullorja e studimeve në UGJ (Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI) dhe Rregullorja e Fakultetit të FESHSH-së (Evidenca 2.5. neni 17, neni 30, neni 31).
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në RVB gjenden dokumente të tilla si : Evidenca 2.2. Plan mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela 14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023. Këto japin informacionet e nevojshme të kërkuara nga ky kriter mbi për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Në RVB theksohet se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet. <i>Sugjerohet që gjatë rishikimit të radhës të rifreskohet literatura dhe bashkë me të bëhet rifreskimi i temave të caktuara të silabuseve, në përputhje edhe me të dhënat më të reja të metodologjive të aplikuara në botë në lidhje me analizën e korpusit gjuhësor në përgjithësi e të atij të shqipes në veçanti.</i>
	Kemi sugjeruar dhe në kriteret paraprirëse se proces i tillë është domosdoshmëri, pasi rrit cilësinë e mësimdhënies dhe debatit shkencor. Njëkohësisht kjo është një kërkesë e parashikuar edhe nga kriteret përkatëse të standardeve për akreditim. Evidenca 2.9. Vendim Rektorati nr. 06, datë 26.3.2018, Për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019; Evidenca



	2.10. Vendim nr.17, datë 8.7.2021 i Senatit Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022.			
Konkluzione	<i>Ky standard vlerëson nëse programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</i> <i>Sugjerojmë që gjatë rishikimit të radhës të silabuseve të rifreskohet literatura dhe bashkë me të bëhet rifreskimi i temave të caktuara të silabuseve, në përputhje edhe me të dhënat më të reja të metodologjive të aplikuara në botë në kuadrin e analizës së korpusit gjuhësor në përgjithësi e të atij të shqipes në veçanti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	RVB-ja sqaron se programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” ka të përcaktuar qartë emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, shpërndarjen e lëndëve, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas legjislacionit referues (Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimit Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar). Në këto dokumente shihet se lëndët janë kategorizuar në: a) Lëndë bazë; b) Lëndë karakterizuese; c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese;

	d) Lëndë plotësuese; e) Detyrime përmbyllëse. Në përfundim të studimeve ky program i pajis studentët me një formim bazë në fushën e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, i cili do t'u shërbejë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. <i>Sugjerojmë sërish rikonceptim të emërimit në "Gjuhësi dhe Letërsi" në mënyrë që të rritet mundësia e zgjerimit të aksesit në një treg më të gjerë pune, përthithjes së një numri më të madh studentësh, si dhe mundësisë së shfrytëzimit të kapaciteteve akademike të degëve të ngjashme në mësimdhënie, përderisa gjatë vizitës në Universitet na u pohua mungesa e stafit akademik.</i> (Evidenca 2.2 Plan mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024); ANEKS-Tabela përmbledhëse. Tabela 14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023). Evidenca 2.21. Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni. Tabela nr. 23.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet.	Konstatojmë se në përgjithësi lëndët dhe shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është bërë, duke pasur parasysh vështirësinë e konceptimit të tyre, hierarkinë e formimit të koncepteve si dhe ndërvlerësinë e lëndëve me njëra-tjetrën. Ky lloj programimi është bërë duke pasur parasysh edhe përvojat e institucioneve homologe. <i>Sugjerojmë gjithsesi gjetjen e mundësive zgjerimit të disiplinave të aplikuara të tilla si analizë diskursi, pragmatikë, semantikë gramatikore, gjuhësi teksti, analizë kritike diskursi, semiotikë, psikolinguistikë etj., pasi nëpërmjet tyre jo vetëm bëhet aplikimi i njohurive tradicionale strukturale, por veprimtaria akademike bëhet më koherente me zhvillimet më të fundit në botë.</i> Evidenca 2.2. Plan mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e	Nga shqyrtimi i RVB-së mund të pohojmë se struktura e programit, lëndët, raporti teori -praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit.



programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Natyrisht që është e lehtë të vëresh ngjashmërinë e tij në lidhje me institucionet analoge brenda vendit. Në RVB pohohet se këto programe janë të ngjashme edhe me ato jashtë vendit, po ne mendojmë se një gjë e tillë është mjaft relative, pavarësisht se një pjesë lëndësh kryesore emërtohen njësoj të tilla si: fonetika, sintaksa, morfologjia, semantika; studimet në letërsi të krahasuar, shkencën e letërsisë apo njohuritë nga letërsia botërore. Mendojmë se pikërisht përshtatja edhe nga trajtimi, pra përmbajtja e secilit program lëndor në koherencë me praktikën më të mira europiane mbetet sfida si e programit të paraqitur në këtë aplikim, ashtu edhe të tjerave në institucionet tona të arsimit të lartë. Kurrikula e programit të studimeve Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" është organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, mesatarisht 30 kredite për semestër. Ngarkesa në kredite për çdo vit akademik është 60 ECTS, një praktikë kjo e njëjtë me programet të ngjashme ndërkombëtare. <i>Për këtë arsye sugjerojmë që deduktimet në një pjesë lëndësh të mos i referohen vetëm korpusit të shqipes, por të kenë edhe shembuj kodesh të tjera.</i> Një gjë e tillë do të kushtëzonte përdorimin e më shumë literaturave të huaja e në këtë mënyrë edhe rifreskimin e tyre dhe metodologjive që gjenden në to, të cilat sot janë shumë më specifike se këndvështrimet tradicionale, që gjendet në studimet për shqipen, të referuara rëndom në literaturat e detyrueshme e fakultative të silabuse të këtij programi. Evidenca 2.2. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe"; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Edhe në kriteret e mësipërme u saktësua se plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" parashikon ndarjen e lëndëve në përputhje me kërkesat ligjore, duke ruajtur raportin midis formimit teorik dhe praktik, dhe duke mundësuar arritjen e objektivave formuese. Gjithashtu, programi mundëson pjesëmarrjen e studentëve në praktikën në terren, pavarësisht se kjo e fundit nuk parashikohej direkt nga programi (e kemi fjalën për praktikën mësimore). Pra kjo praktikë realizohet nëpërmjet ekspeditave ku mbledhet material gjuhësor dhe letrar.



	Mendojmë se ngjashmëria e profilit të programit të studimit me universitetet shqiptare dhe ndërkombëtare krijon mundësi të transferimit të studimeve në universitetet me program të ngjashëm, si: në Universitetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës, Durrësit, Korçës, Elbasanit si dhe në universitetet e Prishtinës, Gjakovës, Prizrenit, Shkupit. Theksojmë se ngjashmëria e këtij programi me institucione homologe vlen vetëm për universitetet shqiptare e ndonjë ballkanik, pasi në lidhje me ato europiane ky program ka ndryshime të konsiderueshme veçanërisht në konceptim dhe literaturë, qoftë edhe për ato lëndë me emërtim të njejtë. Në këtë kuadër, përsëri mbetet sugjerimi i përmendur në disa kritere në lidhje me rifreskimin e silabuseve, literaturave dhe aplikim të metodologjive bashkëkohore. Evidenca 2.2. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe"; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023 Evidenca 2.13. Modeli i diplomes Bachelor në "Gjuhë dhe letërsi shqipe"; Aktet e miratimit; Evidenca 2.14. Model suplementi të diplomës, Vendim nr. 16, datë 8.7.2021, SA-së. Evidenca 2.15. Struktura mësimore 2022-2023.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në RVB pohohet procesi i realizimit të silabuseve në këtë mënyrë. Në të jepen procedurat standarde të realizimit të silabuseve, rifreskimit të literaturave etj., po nuk jepen të dhëna konkrete në lidhje me aplikimin e tij. Kriteri kërkon pasqyrim të rifreskimit të silabuseve, jo vetëm identifikim procesi. Mendojmë se mund të rikonceptohet ky kriter , duke shtuar të dhëna konkrete të kërkuara në lidhje me të. Pra pohimi i mëposhtëm që gjendet në RVB "Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar synohet të jetë bashkëkohore" të konkretizohet . Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 19, pika 2/b. ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023 Evidenca 2.22. Miratimi i teksteve bazë në njësitë bazë përgjegjëse 2022-2023;
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e	Konstatohet se përgjithësisht përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", e organizuar me lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore,

dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	lëndë plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse, është organizuar në mënyrë të atillë që të garantojë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, të pasqyruara në çdo program lëndor (syllabuset). <i>Përsëri sugjerojmë rritjen e kësaj kompetence me rifreskim metodologjik e literaturash, pra me një koherencë më të madhe të tyre me manualet më të fundit botërore.</i> Evidenca 2.2. Plan mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", 2021-2024; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Konstatohet se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimit si "Master në mësuesi për AMU në Gjuhë-letërsi" pranë UGJ-së ose Master profesional/Master i Shkencave pranë Universiteteve të tjera publike dhe jopublike. <i>Sugjerojmë që në silabuset në përmirësimet vjetore të pasqyrojnë kompetenca specifike që rrisin mundësitë e punësimit në tregje të reja pune të tilla. Natyrisht që një gjë e tillë specifikohet më tej në studimet master, po edhe këtu në kuadrin e lëndëve me zgjedhje mund të diskutohen lëndë që krijojnë kompetencë në lidhje me turizmin kulturor të niveleve të ndryshme, në lidhje me artin skenik, në lidhje me turizmin malor etj.</i> Evidenca 2.21. Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni për punësim; Evidenca 2.23. Lista e fituesve në programin e studimit të ciklit të dytë Master "Në mësuesi në AMU në gjuhë -letërsi", viti 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023;
Konkluzione	<i>Në këtë standard pasqyrohen të dhëna që lidhen me strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programeve të studimit, përputhshmërinë e tyre me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Vëmë re se ka akoma punë për të bërë në këtë kuadër. Sugjerojmë rifreskim silabusesh të mbështetura në literatura bashkëkohore të huaja, në të cilat gjenden metodologji më frutdhënëse, që garantojnë jo vetëm kompetencë që lidhet me korpusin e shqipes, po edhe më gjerë, si dhe krijojnë mundësitë</i>



	<i>e rritjes së tregut të punës, që nuk duhet mbështetur vetëm në nxjerrjen e mësuesve, po edhe studiuesve e më gjerë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në RVB theksohet se në çdo fundviti akademik njësitë bazë organizojnë diskutime në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, përmirësimin, duke pasur parasysh ndryshimet dhe zhvillimet e vazhdueshme në lëndët përkatëse në arsimin parauniversitar (AMU). Nga vizita e bërë në Universitet, duke vlerësuar produktivitetin shkencor të stafit akademik, po edhe nga numri aktual i studentëve, sugjerojmë kërkimin e rrugëve të reja që të stimulojnë secilën nga këto elemente që përmendëm. Në radhë të parë krijimi i mundësive për mobilitete afatgjata trajnimit të stafit akademik. Më tej koherenca në silabuse e në literaturë me programet e ngjashme botërore dhe së fundi përshtatja me nevojat rajonale të këtyre kompetencave në mënyrë që të sigurohet tregu i punës dhe të mos mbetet vetëm në kuadrin riprodhues veprimtaria shkencore. Evidenca 2.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", 2018-2021; Evidenca 2.2. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", 2021-2024; ANEKS-Tabela përmbledhëse. Tabela nr. 11.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në	Gjatë vizitës dhe specifiku takimit me studentët nuk vumë re të dhëna të mjaftueshme në lidhje me ndikimin e studentëve në procesin e përmirësimin të programit dhe silabuseve të tij. Mendojmë se duhet stimuluar vetëdijësimi i studentëve për rolin që kanë në këtë proces, qoftë edhe duke ju kërkuar në formë të shkruar shprehjen e vullnetit të tyre. Një gjë ë tillë mendojmë se rrit edhe interlokucionin dhe interaktivitetin në të mirë të përbashkët të dy palëve.

ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Evidenca 2.25. Lista e anëtarëve të senatit akademik të UGJ-së, Vendim i SA-së, nr.22, datë 3.7.2020. Evidenca 2.26. Statuti i Këshillit studentor të UGJ-së; Evidenca 2.26.1 Lista e Këshillit Studentor; Evidenca 2.27. Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së programeve të studimit të ofruara nga universiteti "E. Çabej". në UGJ, faqe 9.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Gjykojmë se ka punë për të bërë në lidhje me përditësimin e programeve dhe literaturave. Është një sugjerim i përsëritur ky edhe në kriteret më lart. Gjithsesi mendojmë se është sfidë jo vetëm për të Universitet, po për të gjitha universitetet tona një pikërisht përditësimi i programeve dhe literaturave përkatëse në koherencë me ato të homologeve tona europiane. Në RVB theksohet se organizimi i aktiviteteve shkencore është në të mirë të këtij procesi, po gjithsesi puna individuale e stafit akademik e reflektuar edhe në sillabuse është një garanci për përmirësimin e kërkesave gjithnjë e në rritje të realiteti shkencor më bashkëkohor. Evidenca 2.28 Vendim i SA-së, nr.25, datë 9.9.2021, Për zhvillimin e lëndës "Shkrim dhe menaxhim projektsh"; Evidenca 1.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve, mobiliteteve të UGJ-së;			
Konkluzione	<i>Ky standard kërkon të dhëna në lidhje me nxitjen dhe përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Në të pranohet në përgjithësi ekzistenca e këtyre komponenteve, po nga kontaktet gjatë vizitës dhe nga informacionet e dhëna në RVB, na rezulton se është e nevojshme vetëdijësimi i studentëve në lidhje me rolin e tyre në hartimin e programeve mësimore, që këto të fundit të jenë në funksion të kompetencave të dëshiruara ndërkombëtare dhe rajonale, në mënyrë që t'u sigurohet atyre dhe një treg pune i sigurt. Po kështu, përsëri mbetet në nivele të dëshirueshme numri i kontakteve veçanërisht ndërkombëtare, në mënyrë që të shfrytëzohen përvojat e tyre në këtë kontekst.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në RVB dhe nga vizita në Universitet mund të pohojmë se format e mësimdhënies janë ato klasike dhe në përputhje të plotë me kërkesat e këtij kriteri (Kemi parasysh të dhënat që gjenden në RVB: Leksione (I) 322.5 + (II) 420 + (III) 355= 1097.5 orë Seminare (I) 315 + (II) 240 + (III) 235= 790 orë Praktika në terren (III) 50 orë Studim individual (I) 862.5 + (II) 840 + (III) 910= 2612.5 orë). Po kështu, gjatë vizitës u njohëm me infrastrukturën aktuale të mësimdhënies dhe pamë se ekzistonin ambientet e nevojshme, pavarësisht se ka vend për përmirësimin e tyre si në raport me kushtet e sistemit të ngrohjes dhe ftohjes së sallave, paisjen e tyre me mjetet elektronike të nevojshme për mësimdhënie e mësimnxënie, përmirësimin e infrastrukturës së laboratoreve etj. Evidenca 2.2. Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”2021-2024; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” 2022-2023.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi	Nga vizita në Universitet vërejtëm se klasat kanë nevojë për rinovim dhe pajisje të tyre me mjetet e nevojshme për të realizuar një mësim efektiv të tilla si power point statik, tv me touch screen të lidhur me internet etj. Përmirësimi i laboratorëve të ndryshëm, si dhe shtimi i hapësirave të bibliotekës dhe vecanërisht i fondit me tituj të rinj në lidhje me fushat specifike që ofron ky program studimin është i nevojshëm.



alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Po kështu, një hapësirë më e bollshme për stafin akademik është e domosdoshme në funksion të rritjes së nivelit të tyre akademik dhe funksionimit normal të marrëdhënies me studentët. Evidenca 3.1. Urdhër i Rektoratit për platformën e mësimi online, nr.17, datë 18.3.2020; Evidenca 3.2. Implementimi i platformës së mësimi online Classroom; Evidenca 3.3. Implementimi i platformës së mësimi online Edumeet; Evidenca 3.4. Implementimi i platformës së mësimi online Office 365; Evidenca 3.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët; Evidenca 3.6. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për pedagogët 2020-2021; Evidenca 3.7. Format e zhvillimit të provimeve online 2020-2021; Evidenca 3.8. Rregullore për format e zhvillimit të provimeve në universitetin "E. Çabej", 2020-2021; Evidenca 3.9. Vendim Senati, nr.4, datë 2.2.2021, Për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca 3.10. Vendim i Rektoratit, nr.12, DATË 22.9.2020, Për format e zhvillimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021; Evidenca 3.11. Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie; Evidenca 3.12. Vendim i SA-së, nr.37, datë 14.11.2022 për miratimin e strategjisë për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në IAL, 2023-2028;
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga vizita në Universitet gjykojmë se shtimi i ambienteve (zyra) për pedagogët, dhe shtimi i fondit në lidhje me blerje librash të printuar është i nevojshëm për stimulimin e kërkimit shkencor. Po kështu, gjykojmë se platformat on-line të përdorura në pandemi të vazhdojnë të përdoren si në një mjet komunikimi student -pedagog, për dërgimin e materialeve, marrjen e detyrave, në mënyrë që edhe evidentimi nga hierarkitë përkatëse i cilësisë së komunikimit të jetë më i lehtë. <i>Duhet të ripërsërisim që për të zbatuar sa më mirë këtë kriter të domosdoshëm, nevojë e përsëritur është përditësimi i bibliotekës me tituj të printuar sa më bashkëkohorë.</i> Evidenca 3.13. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në Njësitë bazë përgjegjëse;

	Evidenca 3.11. Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie; Evidenca 3.12. Vendim i SA-së, nr.37, datë 14.11.2022 për miratimin e strategjisë për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në IAL, 2023-2028; Evidenca 3.6. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3. 14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studenti mendimin krijues, atë kritik, si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga vizita e bërë në Universitet dhe në bashkërendim me RVB-në e paraqitur theksojmë se është i domosdoshëm krijimi i mundësive të stafit akademik për mobilitete trajnimi me fat 6 mujor e lart, në mënyrë që kompetenca shkencore të rritet. Po kështu vumë re se veprimtaritë që lidheshim me studentët ishin të pakta, ndaj dhe sugjerojmë një atmosferë më të gjallë në lidhje jetën studentore në bashkërendim me atë akademike. Në këtë kuadër <i>mund të sugjerohen workshop-e me tematika të ndryshme që lidhen si me kompetencën akademike, ashtu edhe atë humane-komunikative.</i> Në lidhje me këto të fundit mund të shtohet roli i studentëve si pjesë e një sistemi tutorial që do krijonte mundësinë e komunikimit profesional vecanërisht mes tyre, po edhe me stafin akademik. ANEKS-Tabelat përmbledhëse, Tabela 6. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Evidenca 3.15. CV-të e Personelit Akademik të njësive përgjegjëse për programin e studimit; ANEKS-Tabelat përmbledhëse, Tabela 4. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" në vitin akademik 2022-2023; Evidenca 3.16. Urdhër nr.16.datë 25.3.2022 për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në Universitetin "E. Çabej";3.36. 1. Raport i pyetësorit për procedurën e mësimi online.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Në RVB në lidhje me këtë kriter pohohet se në menyrë të periudike realizohen anketa me pyetësorë në lidhje me këtë proces, duke dhënë informacion mbi pyetësorin e realizuar në periudhën 11 prill -2 maj 2022. Gjatë këtij procesi kanë plotësuar pyetësorin rreth 12 % e studentëve të të gjitha degëve në mënyrë vullnetare. Rreth 55% të tyre kanë dhënë preferencën kënaqshëm në lidhje me procedurën e mësimi on-line. Duhet theksuar se numri i studentëve që lidhen me këtë program të ofruar për akreditim, që plotësuan këtë formular me dëshirë është vetëm 4. Ndoshta do ishte mirë nxitja e shprehjes së një numri më të madh studentësh të kësaj dege,

	në mënyrë që të njihej dhe pasqyrohej sa më saktë dhe opinioni i studentëve në lidhje mesimdhënien. 3.16. 1. Raport i pyetësorit për procedurën e mësimit online.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mesimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mesimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mesimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mesimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Nga konsultimi i RVB-së dhe vizita në Universitet vërejmë ekzistencën e e dy sektorëve që kontribuojnë në plotësimin e këtij kriteri: a. Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave b. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë Pas konsultimit të Evidencës 1.21 mund të pohojmë se mobilitetet e studentëve janë më të shumta në numër të stafit akademik. Edhe mobilitetet e stafit akademik më së shumti i përkasin shtrirjeve kohore minimale 5+2, gjë që e bën të pamjaftueshëm trajnimin e tyre. Gjithashtu, një pjesë e mirë e marrëveshjeve mbeten memorandume honorifike të paaktualizuara a konkretisht në lidhje, si me mobilitetet, ashtu edhe me kualifikimin shkencor. Po kështu, në RVB theksohet UGJ-ja ka revistën e tij shkencore “Kërkime Universitare” në format letër dhe në format elektronik, e pajisur me ISSN: 2226-082X, e cila pasqyron botimet më të fundit të Institucionit. Ky organ është një mundësi e mirë e publikimit të produktit shkencor. Natyrisht që botimi i saj sa më i shpeshtë dhe shtimi i autorëve që vijnë jo vetëm nga Universiteti do të krijonte një fond akademik referues serioz. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 42; Evidenca 3.11. Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mesimdhënie; Evidenca 3.12. Vendim i SA-së, nr.37, datë 14.11.2022 për miratimin e strategjisë për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mesimdhënies dhe mesimnxënies në IAL, 2023-2028; Evidenca 1.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve, mobiliteteve të UGJ-së; Evidenca 3.17. Periodikët e botuar në UGJ; Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 84.
Konkluzione	<i>Ky standard merret me garantimin e procesit të të nxënës, aftësimit profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Në këtë kontekst sugjerojmë përmirësimin e infrastrukturës si për pedagogët, ashtu dhe studentët, për një mesimdhënie e mesimnxënie më efektive. Shtimi i sallave të</i>



	<i>punës për pedagogët, paisja e sallave të mësimi me power point statik, tv me touch screen dhe lidhjen e tyre me internet, paisjen e sallave me sistem ngrohës dhe ndërrimin e tabelave nga ato me shkumës, në ato magnetike etj. Janë elemente të domosdoshme.</i> <i>Gjithashtu, sugjerojmë shtimin e mobiliteteve afatgjata për pedagogët, në të mire të kualifikimit adekuat shkencor të tyre.</i> <i>Të punohet me vizion që marrëveshjet e firmosura të mos mbeten vetëm në kuadrin honorifik, po të shfrytëzohen në funksion të rritjes së kompetencës student-pedagog. Marrëveshje të tilla kishte me disa universitete europiane. Në këtë kuadër mund të diskutohet edhe për programe të përbashkëta e trajnime konkrete.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit pamë se kriteret dhe mënyra e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në një sërë rregulloresh (Rregulloren e UGJ-së; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nent 68, 81, 82, 83; Rregulloren e studimeve në UGJ; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 39, 40, 41, 62, 63, 64; Rregulloren e FESHSH-së; Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-së në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, neni 32,33,34,35,36,37,38,39; Rregulloren e NJBGJSH/Rregulloren e NJBL; Evidenca 2.12. Rregullore e NJBGJSH/ Rregullore e NJBL, neni18/ neni 18; Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”; Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në” Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, fq.10-11; Programet Lëndore; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në”Gjuhë

	dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023; Udhëzimet institucionale; Evidenca 3.18. Vendim i Rektoratit nr.04, datë 10.02.2022 Për miratimin e formatit të unifikuar në rang universiteti për tezën e provimit; Evidenca 1.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve, mobiliteteve të UGJ-së;). Rregulloret e mësipërme janë të publikuara në faqen zyrtare web të UGJ-së, ku studentët mund të informohen në lidhje me kriteret e mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Procedurat e parashikuara nga këto akte normative janë standard, ndaj dhe mendojmë se e përmbushin kriterin përkatës.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga konsultimi i materialve të RVB, si dhe nga takimi me studentët konfirmojmë se ata janë të informuar mbi këtë proces. Kriteret dhe mënyra e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në njw swrw aktesh normative Rregulloren e UGJ-së; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nent 68, 81, 82, 83; Rregulloren e studimeve në UGJ; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nenet 39, 40, 41, 62, 63, 64; Rregulloren e FESHSH-së; Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-së në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, neni 32,33,34,35,36,37,38,39; Rregulloren e NJBGJSH/Rregulloren e NJBL; Evidenca 2.12. Rregullore e NJBGJSH/ Rregullore e NJBL, neni18/ neni 18; Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe"; Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në" Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", fq.10-11; Programet Lëndore; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në"Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023; Udhëzimet institucionale; Evidenca 3.18. Vendim i Rektoratit nr.04, datë 10.02.2022 Për miratimin e formatit të unifikuar në rang universiteti për tezën e provimit; Evidenca 1.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve, mobiliteteve të UGJ-së;). Rregulloret e mësipërme janë të publikuara në faqen zyrtare web të UGJ-së, ku studentët mund të informohen në lidhje me kriteret e mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Procedurat e parashikuara nga këto akte normative janë standard, ndaj dhe mendojmë se e përmbushin kriterin përkatës.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vërejmë se sipas RVB-së vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e lëndës dhe provimi final. Vlerësimi i vazhduar përfaqëson 20% të vlerësimit përfundimtar. Testimi final bëhet në përfundim të lëndës dhe zhvillohet si provim me shkrim. Numri i pyetjeve (pyetje teorike ose ushtrime) që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i lëndës, numri i leksioneve dhe seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje teorike dhe /ose ushtrime që vlerësohen në total me 80 pikë. Për çdo pyetje/ushtim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të pyetjes/ushtimit. Duke qenë se numri i studentëve nuk është i madh, sugjerojmë që në raste të caktuara në vlerësim të pasqyrohen edhe kontribute vetiake që lidhen me aktivizimin e tyre në aktivitete specifike të karakterit profesional në lidhje me lëndë të caktuara. Konstatojmë se procesi i vlerësimit të studentëve mbështetet në një sërë dokumentesh (Rregullorja e UGJ-së, Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e FESHSH-së) etj. Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 39, pikat 5, 6; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023; Evidenca 3.18. Vendim i Rektoratit nr.04, datë 10.02.2022 Për miratimin e formatit të unifikuar në rang universiteti për tezën e provimit; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu V, Nenet 39, 40, 44; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Ky kriter kërkon të dhëna që përsëriten edhe në kritere të tjera, ndaj dhe ne na duhet të përsërisim faktin se pavarësisht punës së bërë në kuadër të përmirësimit metodologji dhe didaktik të stafit akademik, ka përsëri vend për përmirësim. Një gjë e tillë mund të reflektohet direkt në përditësimin e literaturave bashkëkohore, të cilat reflektojnë dhe metodologji të reja si në aspektin shkencor, ashtu dhe në atë didaktik. Natyrisht që në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve në këtë proces, duke ju referuar dhe shkresës përkatëse që pasqyron raportin në lidhje me të dhënat e pyetësorëve organizuar gjatë periudhës 11 prill 2022-2 maj 2022 ripërsërisim se duhet



	nxitur mendimi i tyre, pasi numri i studentëve të shprehur nga kjo degë ishte i ulët (4 vetë). Evidenca 3.16. Urdhër nr.16.datë 25.3.2022 për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në Universitetin "E. Çabej"; 3.16. 1. Raport i pyetësorit për procedurën e mësimimit online.
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Komisioni , gjatë vizitës në Universitet, konstatoi përpjekje të vazhdueshme të stafit akademik për përmirësimin e e mësimdhënies, infrasturës së saj, hartimit të udhëzuesve të ndryshëm që orientojnë në këtë proces, si dhe raportit të komunikimi e të bashkëveprimit me studentët e degës. Gjithsesi sugjerojmë vazhdimin e kontaktit me studentët nëpërmjet metodave elektronike për të çuar dhe marrë detyra, literaturë, pyetje të ndryshme etj. Po kështu shtimi i numrit të librarive elektronike dhe gamës së librave, që ata kanë në dispozicion, është i këshillueshëm. Rritja e fondit për porositjen e librave të printuar gjithashtu do të ndikonte në një mësimdhënie e mësimnxënie më të mirë. Sallat e mësimimit mund të pajisen me videoprojektorë statikë, tv me touch screen dhe lidhje me internet të bollshëm. Të ofrohet ngrohje dhe ambientet e bibliotekës të jenë më të gjera. <i>Mirë është që Universiteti të këtë në dispozicion një fond për lektorë të ftuar që të japin periodikisht leksione, në mënyrë që të ketë krahasim dhe shkëmbim të eksperiencave më të mira.</i> Evidenca 3.1. Urdhër për platformën e mësimimit online; Evidenca 3.2. Implementimi i platformës së mësimimit online Classroom; Evidenca 3.3. Implementimi i platformës së mësimimit online Edumeet; Evidenca 3.4. Implementimi i platformës së mësimimit online Office 365; Evidenca 3.6. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet; Evidenca 3.10. Vendim i Rektoratit, nr.12, DATË 22.9.2020, Për format e zhvillimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021; Evidenca 3.8. Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.9. Vendim Senati nr.4, 2.2.2021. Për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca 3.7. Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.19. Kodi i Etikës dhe vendimi nr.26,datë 8.9.2020. Për miratimin e Kodit të Etikës.

	ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023. Evidenca 3.12. Vendim i SA-së, nr.37, datë 14.11.2022, Për miratimin e strategjisë për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në IAL, 2023-2028; Evidenca 3.6. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit. Evidenca 3.13 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në Njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit; Evidenca 3.11. Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie;			
Konkluzione	<i>Ky standard merret me identifikimin e rregulloreve dhe procedurave të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. Vërejmë se në përgjithësi kriteri është plotësuar, pasi Universiteti ka hartuar dokumentacionin përkatës në lidhje me të.</i> <i>Po kështu, nga vizita në Universitet, verifikuam efektivitetin e tyre. Ngelet punë për të bërë në fuksion të përmirësimit të infrastrukturës së brendshme të klasave, si dhe shtimit e zgjerimit të bibliotekave virtuale dhe mbienteve fizike të asaj ekzistuese. Gjithashtu, duhet shtuar fondi për shtimin e librave të printuar, si dhe afrimin e lektorëve të ftuar të specializuar në fusha specifike në kuadrin e cikleve të leksioneve semestrale, siç aplikohen në universitetet europiane.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik	Konstatojmë se mënyra e vlerësimit kryhet tashmë sipas një procesi të njohur dhe të përshkruar edhe kërkesat e kriterëve më lart. Ai u referohet dy fazave: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar



dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	• Vlerësimi me provim, i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar. Studentët kanë të drejtën të hyjnë provimin përfundimtar pasi të kenë të realizuar një numër të caktuar orësh në auditor (përafërsisht 75%). Në bazë të këtij frekuentimi ata mund të futen në provim (ose jo). Vlerësimi përfundimtar bëhet duke i mbledhur të dy rezultatet dhe duke i klasifikuar sipas një sistemi pikësh (që mbaron me notë maksimale 10 e minimale 4). Rregullorja e studimeve në UGJ-së (Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu V), Rregullorja e FESHSH-së (Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-së Kreu VI), Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe letërsi shqipe” (Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, fq.10-11 Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ (Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.39, pika 5) dhe në programin e lëndës (ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” 2022-2023), vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga: • (Evidenca 3.18. Model i unifikuar i tezës së provimeve) Bazuar në Rregulloren e UGJ-së (Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 81, pika 1) (Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 89)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga vizita në Universitet konstatuam se procesi i korrigjimit të provimit me shkrim realizohej nëpërmjet korrigjimit manual, për arsye të numrit të vogël të studentëve, ndërsa CLEANSORE dhe alternativat që ofronte Microsoft Teams për korrigjim ishin aplikuar vetëm gjatë mësimit online. Sugjerojmë që, pavarësisht se numri i studentëve është i vogël, 60% e provimit të çdo lënde të realizohet më pyetje me alternativa dhe të korigjohet nëpërmjet CLEANSORE, në funksion të rritjes së objektivitetit të korrigjimit. Një gjë e tillë mund të sanksionohet me urdhër të brendshëm (U referohemi në këtë mënyrë praktikave më të mira si në Shqipëri, po veçanërisht jashtë.).



	Evidenca 3.8. Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.9. Vendim nr. 4, 2.2.2021 i SA-së për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca 3.7 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Gjatë vizitës në Universitet dhe kontaktit si me stafin akademik, ashtu dhe me studentët, konstatuam se tezat e provimit ishin në përputhje me materialin e parashikuar në sillabuse. Po kështu, procesi realizohej sipas akteve normative të parashikuara në këtë kontekst. Të dhënat në lidhje me procesin janë përshkruar edhe në kriteret paraprirëse, ndaj nuk po i përsërisim. Evidenca 2.1 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 39; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” 2022-2023), Evidenca 3.18. Model i unifikuar i tezës së provimeve). Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 81, pika 1) (Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 89.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Të dhënat në lidhje me këtë kriter parashikohen sërish në rregulloret përkatëse, pasi vlerësimi në dy faza e përkatësisht vlerësimi i vazhduar, është ai që përllogarit feedback-un e parashikuar në këtë kriter. Ai gjithsesi është më se i arsyeshëm, pasi merr parasysh investimet akademike të studentit gjatë procesit mësimor. Po në këtë kuadër kontribuojnë edhe detyrat me shkrim, apo projekte të ndryshme që mund të realizohen në kuadër të lëndëve të ndryshme dhe që janë pjesë e këtij kontributi të vazhduar të tij. Njohja me rezultatet paraprake të provimit u bëhet me dije studentëve nëpërmjet publikimit online në librezën e tyre elektronike (në sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora) ose pranë njësive bazë brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij [Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 90). Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta që të rishikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut dhe të paraqesin ankesat e tyre në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut.



	Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 46). Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimi për rezultatin e provimit nga studenti.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në RVB theksohet se personeli akademik i NJBGJSH-së dhe NJBL-së ndjekin rregulla strikte për të evituar çdo formë të plagjiaturës apo kopjimit në provime dhe detyra për studentët që frekuentojnë programin e studimit. Gjithshtu, në RVB ka një numër të konsiderueshëm aktesh normative që sanksionojnë penalitetet përkatëse nëse ndodhin këto fenomene. <i>Sugjerojmë pajisjen e instancave të caktuara që merren me etikën dhe mbikëqyrjen e fenomeneve të tilla, që të pajisen me programet përkatëse antiplagjiaturë. Një gjë e tillë duhet parë si domosdoshmëri. Në këtë kontekst sugjerojmë që çdo temë që dorëzohet të pajiset me certifikatën antiplagjiaturë.</i> Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 44, pikat 9, 10), Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenet 86, 87, 88), Evidenca 3.19. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 23, 24) ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” 2022-2023). Evidenca 3.19. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 25, 26).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në RVB përshkruhet procesi i plotë i kontrollit të dijeve, që përfshin si kontrollin e vazhduar dhe atë përfundimtar. Po kështu theksohet se në fund të procesit mësimor studentëve ju komunikohet rezultati i kontrollit të vazhduar. Studentët kanë një afat kohor që të kontrollojnë provimin me shkrim dhe të ankohen, brenda 8 ditëve, nëse kanë vërejtje. Teza e provimit përmban pyetje që përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, dhe për çdo pyetje/ushtrim paraqiten pikët përkatëse. Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin e fletoreve është Përgjegjësi i njësisë bazë ose një person i autorizuar prej tij. Sekretimi bëhet në prani të komisionit.

	Sugjerojmë sërish që korrigjimi të kryhet nëpërmjet projektit CLEANSORE për të paktën 60% të tezës. Evidenca 3.19. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Neni 8, pika 2. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 81, pikat 1. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 83, pikat 1, 2, Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 35, pika 6. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 90), Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-së, Neni 35, pika 16.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga vizita në Universitet dhe nga takimi me studentët konstatohet se ekziston baza ligjore që garanton të drejtën e studentëve për t’u njohur me vlerësimin. Po kështu aplikohen të drejta e tyre për rishikim të tezës e në këtë mënyrë edhe të vlerësimit. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, neni 90; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, nenet 45, 46.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga vizita në Universitet konstatohet se praktikatat ligjore të hartuara nga UGJ janë shumë të sakta e transparente edhe në lidhje me këtë aspekt. Në raste të tilla studenti bën kërkesë me shkrim që i adresohet Dekanit dhe ai ngre komisionin në lidhje me sqarimin e çështjes. Nga takimi me studentët morëm informacion se ata kishin informacion të plotë në lidhje me aktet përkatëse, pavarësisht se nuk i kishin aplikuar, sepse nuk kishin pasur raste të tilla. Duke qenë në numër të vogël marrëdhënia me pedagogët është më direkte, ndaj dhe nuk kanë pasur problematika të tilla na sqaruan ata. Evidenca 2.1 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, neni 46.
Konkluzione	<i>Ky standard identifikon punën e institucionit për një vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Në përgjithësi ky standard përmbushet plotësisht. Sugjerojmë aplikimin e korrigjimit të provimeve me CLEANSORE në masën 60% të provimit.</i>

	Gjithshtu sugjerojmë pajisjen e njësisë përkatëse Komisionit të Etikës me programe antiplagjatur . Studentët që mbrojnë tema duhet të marrin një vërtetim në këtë njësi para se ta mbrojnë atë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga shqyrtimi i dosjes konstatohet se në përgjithësi programi i studimit garanton njohuri dhe zhvillon aftësi që lidhen me fokusin kryesor të hulumtimit të tij. Në të më së shumti jepen njohuri që trajtohen metodologjikisht sipas silabuseve tradicionale, të ngjashme dhe me institucione homologe të tjera brenda vendit. <i>Sugjerojmë shtrirjen e fushës së ekspertizës në një korpus më të gjerë që përfshin edhe kode të tjera. Kjo mund të parashikohet fillimisht me ndryshimin e emërimit të programit në "Gjuhësi dhe Letërsi". Një ndryshim i tillë natyrisht do të reflektohet edhe në sillabuset përkatëse, në literaturat referuese etj. Një gjë e tillë rrit edhe mundësinë e rritjes së kompetencës dhe zgjerimit të mundësive të mobiliteteve të studentëve, pa pasur vështirësi ekuivalentimi të shumë lëndëve gjatë këtyre mobiliteteve.</i> Evidenca 2.3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca 2.3.1. VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca 2.4. VKM Nr. 185, datë 25.03.2021, Aneks-Tabela përmbledhëse. Tabela 9. Evidenca 2.2. Plan mësimor Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2021-2024; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i paraqitur për akreditim është kategorizohet për nga përmbajtja fushën e shkencave humane. Gjithsesi ai mbetet besnik në trajtim në lidhje me njohuritë aplikative që lidhen edhe me teknologjitë e reja të informacionit sot. Kjo

informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	për arsye se në të pasqyrohen më së shumti njohuri që lidhen me strukturën bazë referuese si në gjuhësi, ashtu dhe në letërsi. Në këtë kontekst mendojmë se ka vend për përfshirjen edhe të disiplinave të tilla si gjuhësi informatike që jep të dhën mbi programimin gjuhësor dhe ndihmon në identifikimin e e vlerave të studimeve gjuhësore në fushën e inteligjencës artificiale. Në mënyrë që këto njohuri të aktualizohen edhe për shqipen sugjerojmë shtrirjen e fushës së ekspertizës në një korpus më të gjerë, që përfshin edhe kode të tjera. Kjo mund të parashikohet fillimisht me ndryshimin e emërimit të programit në “Gjuhësi dhe Letërsi” dhe natyrisht kjo do të reflektohet edhe në sillabuset përkatëse, në literaturat referuese etj. Në literaturat dhe manualët akademike të hartuara për kodet e tjera në këto fusha gjenden edhe metodologjitë adekuate që mund të ndihmojnë në këtë fushë.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Gjatë gjithë procesit mësimor dhe, në veçanti, në përfundim të lëndës, personeli akademik orienton studentët, duke vendosur theksin në temat më të rëndësishme të trajtuara në lëndën mësimore. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, evidentohen me rezultatet e tyre në format e ndryshme të vlerësimit të vazhduar përgjatë vitit si dhe në provimet përfundimtare. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, neni 18, pika 3). ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të	Në RVB theksohet predispozita e aplikimit të njohurive të marra nga studentët nëpërmjet seminareve, apo studimit individual jashtë auditorit. Po kështu, detyra në kuadrin e projekteve intensifikojnë bashkëveprimin në grup të tyre. Gjatë këtij procesi studentët kanë në dispozicion bibliotekën digjitale në UGJ dhe një fond librash, të cilat ndihmojnë studentin për të zhvilluar njohuritë, <i>Sugjerojmë shtimin e titujve të librave bazë të fondit të huaj për shumicën e silabuseve në kuadrin e literaturës së domosdoshme.</i> Po kështu pasqyrimin e saktë në çdo silabus të artikujve ose librave që mund të gjenden në libraritë online që Universiteti ka akses. Gjithashtu, shohim si të nevojshme rritjen e numrit të mobiliteteve afatgjata të pedagogëve e studentëve në kuadrin e trajnimit.

përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023. (Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit); Evidenca 3.21. Pjesëmarrje në Panairin Eërk and Study 2022; Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panairin Eërk and Study 2023. Evidenca 3.11. Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga vizita në Universitet, po dhe nga materiali i dosjes vërejmë se personeli akademik përkatësisht CV personale të gjithë pjesëtarëve të njësive bazë merr pjesë në sesione dhe konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Duhet të theksojmë se numri i veprimtarive të Universitetit është i kufizuar në një ose dy konferenca në vit, kjo dhe në varësi të kushteve financiare tij. Gjithsesi, mund të organizohen herë pas here leksione të hapura në formën e work-shope-ve, të cilat të jenë të programuara për secilin anëtar të stafit akademik. Një gjë e tillë nxit aktivitetin akademik dhe diferencon kompetencën statike nga ajo dinamike dhe më efektive. Veprimtari të tilla është mirë të organizohen çdo muaj, ose një herë në dy muaj. Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore shkencore të njësisë bazë të gjuhës shqipe, 2021-2022; Evidenca 1.23 Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore shkencore të njësisë bazë të letërsisë, 2021-2022. Evidenca 3.11.1 Lista e leksioneve të hapura.
Konkluzione	<i>Ky standard identifikon ngritjen e strukturave të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Duhet të theksojmë se procesi mësimdhënës përgjithësisht përputhet me fokusin kryesor të programit që synon dhënien e kompetencave të nevojshme në gjuhësi dhe letërsi shqipe.</i> <i>Sugjerojmë zgjerimin e këtyre kompetencave, duke rritur korpusin e referencës dhe duke ndryshuar emërtimin në "Gjuhësi dhe Letërsi".</i> <i>Një gjë e tillë të reflektohet në sillabuse dhe literaturë, e cila domosdoshmërisht duhet të ketë manuale të huaja si literaturë të detyrueshme.</i> <i>Gjykojmë se kjo shton lehtësinë e mobiliteteve si të stafit akademik, ashtu dhe të studentëve, si dhe rrit tregun e punës së studentëve. Organizimi i leksioneve të hapura periodike</i>



	<i>nga stafi akademik do të shërbente në përmirësimin e kualifikimit shkencor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Konstatohet se zhvillimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës për studentët e programit e ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” rregullohet me akte normative specifike. Kemi parasysh këtu Kreun VIII “<i>Diplomimi</i>”, të Rregullores së Studimeve në UGJ, nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64 Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë), Nenin 93 të Rregullores së UGJ-së (Evidenca 1.7 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë), Kreu VII “<i>Diplomimi</i>”, nenet 39, 40 të Rregullores së FESHSH-së (Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore) (Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë dhe letërsi shqipe, fq. 11-12). Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 59, pika 3; Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 39, pika 2; Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, fq 11-12.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Në RVB po edhe në kritere paraprirëse kemi konstatuar se personeli akademik në bazë dhe të akteve normative bashkangjitur komunikon në fund të ciklit të leksioneve semestrale rezultatet e kontrollit të vazhduar. Në lidhje me provimin përfundimtar studentët orientohen si nga sillabuset e lëndëve, me të cilat janë njohur që në fillim, ashtu edhe nga kontakti direkt me pedagogun e lëndës.

	Në lidhje me provimin përfundimtar ka orientime të sakta të cilat referojnë korpusin teorik e praktik bazë që do të jepet në provim. Praktikrat tradicionale parashikojnë dhe hartimin e një korpusi pyetjesh standarde në lidhje me këtë proces. (Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, neni 61) dhe shtojcave të kësaj Rregulloreje (Evidenca 3.23. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve), Rregullores së programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” (Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gjuhë dhe letërsi shqipe, fq. 11-12) dhe Programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Evidenca 3.24. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar në Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Drejtimi gjuhësi; Evidenca 3.25. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, Drejtimi letërsi.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në aktet nomrative të paraqitura në RVB konstatojmë praktikrat standarde të realizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar/mbrojtja e punimit të diplomës. Ky i fundit realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të njësive bazë, të fushave që mbulon programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. Anëtarët e komisionit propozohen nga përgjegjësi i njësive bazë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Programi hartohet nga personeli akademik i njësive bazë, propozohet nga Përgjegjësi i njësive bazë dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen në përputhje me programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Përgjegjësi i njësive bazë dhe miratohen nga Dekani. <i>Sugjerohet që provimi përfundimtar të korigjohet me CLEANSORE, kur është me shkrim.</i> (Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, neni 62, pika 3, neni 64). (Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, neni 62, pika 2; Evidenca 3.24. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar në Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Drejtimi gjuhësi;

	Evidenca 3.25. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar në Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Drejtimi letërsi. Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 62, pika 4..
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Konstatohet se zakonisht njësia bazë në një mbledhje të posaçme në fillim të viti të fundit përcakton edhe fushat në të cilat do të orientohen temat që do të punojnë studentët. Këto ju komunikohen studentëve që përzgjedhin edhe drejtuesit përkatës. Këta të fundit në bashkëpunim me studentët përcaktojnë dhe kontrollojnë afatet e kryerjes së fazave të planifikuara bashkarisht me studentin (mbledhja e literaturës, leximi dhe konspektimi i saj, mbledhja e korpusit, analiza e tij në bazë të metodologjisë së përzgjedhur, diskutimet dhe përfundimet përkatëse). Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ. (Evidenca 3.26. Miratimi i fushave të studimit). Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 61; Evidenca 3.23. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<i>Sugjerohet shfrytëzimin e marrëveshjeve të ndryshme të firmosura nga UGJ-ja që mund t'ju mundësojnë studentëve kontakt direkt në biblioteka dhe përvoja homologe.</i> Evidenca 3.13. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBGJSH dhe NJBL.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në aktet bashkëngjitur gjenden të sanksionuara kriteret e vlerësimit dhe afatet përkatëse. Sipas tyre në përfundim të provimit të përgjithshëm studenti vlerësohet me notë e cila varion nga 4 (minimalja) deri te 10 maksimalja. Kjo është një procedurë standard, për të cilën nuk kemi sugjerime. Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 62, pika 5 dhe 6, neni 64 pika 3 dhe 4; Evidenca 3.23. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset	Konstatohet se sipas akteve bashkëngjitur në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e

me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	diplomës. Suplementi i Diplomës për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR-së. Pas diplomimit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me syllabuset përkatëse. Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, neni 65; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, neni 76; Evidenca 2.13. Model diplome Bachelor në “Gjuhë dhe letërsi shqipe”; Evidenca 2.14. Model suplementi i diplomës. (Evidenca 3.28. Udhëzim Nr.11, dt. 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR).
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në Universitet konstatuam se institucioni ruan përgjatë viteve të studimit kopje të dokumentacionit të studentit. Studentët, në mbyllje të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. UGJ-ja në përputhje me nenin 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e UGJ-së (Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, neni 44) si dhe Rregullore e Sekretarisë Mësimore (Evidenca 3.27. Rregullore e sekretarisë mësimore, neni 4) administron dokumentacionin e mëposhtëm: • regjistrin themeltar të studentëve. • regjistrin e arritjeve akademike. • regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
Konkluzione	<i>Ky standard verifikon ndjekjen e një procedure të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Në përgjithësi standardi përmbushet plotësisht. Sugjerojmë sërish që kur ka provime me shkrim ato të korigjohen me CLEANSORE. Po kështu, gjatë procesit të përgatitjes së temave të shikohet mundësia e mobiliteteve dhe përdorimit të marrëveshjeve institucionale në mënyrë të frutshme nga ana e studentëve si për akses literaturash, ashtu dhe përvojash.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar te dokumentacioni përkatës përcjellë përmes DVV dhe pas shqyrtimit të CV-ve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", konstatohet se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. 4. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 16 PAE dhe 0 PAK (100% PAE) 5. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 16 PAE dhe 0 PAK (100% PAE) 6. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 15 PAE dhe 1 PAK (93 % / 7 %)								
	<table><tr><th>Tituj/ grada</th><th>2020-2021</th><th>2021-2022</th><th>2022-2023</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Tituj/ grada	2020-2021	2021-2022	2022-2023				
Tituj/ grada	2020-2021	2021-2022	2022-2023						

		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	1	0	1	0	0	0
	Prof.Asc.	3	0	3	0	3	0
	Dr./PhD.	7	0	9	0	9	0
	Msc.	5	0	3	0	3	1
	MP	0	0	0	0	0	0
	Totali	16	0	16	0	15	1
	Gjatë takimeve të zhvilluara me drejtuesit e fakultetit dhe departamenteve si dhe me personelin akademik, u ritheksua se personeli akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Po ashtu, konstatojmë se kualifikimet dhe publikimet e personelit akademik pasqyrohen në raportet vjetore të njësive bazë dhe në Raportet Vjetore të veprimtarisë mësimore kërkimore të FESHSH-së. Evidenca 3.15. CV-të e personelit akademik; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat. 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore- shkencore të njësisë bazë të gjuhës shqipe 2021-2022; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore- shkencore të njësisë bazë të Letërsisë 2021-2022; Evidenca 4.1. Raporti i veprimtarisë mësimore-shkencore të FESHSH-së 2021-2022.						
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Referuar Nenit 59, pikat 3, 4, 5, 6 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM Nr.418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre” dhe bazuar te dokumentacioni i paraqitur në DVV, konstatojmë se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Referuar të njëjtave burime vërehet se personeli akademik efektiv ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës dhe mbulon jo më pak se 93% të ngarkesës mësimore për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”.						

	Evidenca 4.2. V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017, pika 2, gërma a, nënpika xii, pika 2, gërma b, nënpika i, nënpika ii; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Evidenca 4.3. Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar dokumentacionit plotësues të përfshirë në DVV, konstatohet se institucioni garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Evidenca 4.4. Urdhër shpenzimi; Evidenca 4.5. Model kontrate punësim individuale e punës me kohë të plotë, PAE/PAK.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e përçuar në dokumentacionin plotësues të DVV, vërejmë se UGJ-ja ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, të cilat janë të dokumentuara edhe në RVB, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Në evidencat e poshtëshënuara, vërejmë se përcaktohet qartë e gjithë procedura që ndiqet nga institucioni për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme. Kjo procedurë nis në njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, më tej, i përcillet Rektorit të Universitetit, dhe vetëm pas miratimit të tij, duke respektuar bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi, njoftimi për rekrutimin e stafit të ri publikohet në Buletinin e Prokurimeve Publike si dhe në faqen zyrtare web të Universitetit. Referuar Rregullores së punësimit të personelit akademik dhe administrativ, për rekrutimin e personelit me kohë të plotë, me urdhër nga Rektori, ngrihet një komision “ad-hoc” për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant. Ky komision përbëhet nga 5(pesë) anëtarë, ai që kryeson veprimtarinë e komisionit është Dekani i Fakultetit, 3 (tre) anëtarë janë pjesë e personelit akademik të Njesisë bazë përkatëse dhe 1(një) anëtar është nga Rektorati. Komisioni “ad-hoc” në fjalë, asistohet në punën e tij nga Struktura e

	manaxhimit të burimeve njerëzore, e cila mbështet komisionin në zhvillimin e procedurave konkurruese. Disi më ndryshe paraqitet procedura e rekrutimit të personelit me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar. Referuar dokumentacionit të dhënë nga GVB, në të tilla raste, komisioni "ad-hoc" ngrihet nga Dekani i Fakultetit dhe jo nga Rektori, siç ndodh në procedurën e ndjekur nga institucioni për rekrutimin e personelit me kohë të plotë. Nga takimet me përgjegjëset e njësive bazë përgjegjëse për programin Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", stafin akademik dhe përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ vëren se PAE-të, ndonjëherë, duhet të realizojnë një ngarkesë mësimore vjetore edhe më të madhe se ajo që është parashikuar në aktet nënligjore në fuqi. Sipas tyre, edhe kur shpallet konkurs për PAK, nuk ka kandidatë të interesuar për t'u angazhuar në mësimdhënie në UGJ. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 33, 56; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nenet 27, 29; Evidenca 4.6. Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 3, 5, 8 dhe 9. Evidenca 4.7. Propozim për personel akademik me kohë të plotë, Evidenca 4.7.1 Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar, Evidenca 4.7.2 Buletini prokurimeve publike.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, njësitë bazë përgjegjëse për programin Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", në Universitetin e Gjirokastrës nuk kanë personel ndihmës akademik të angazhuar për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në	Bazuar në dokumentacionin plotësues në DVV, dhe gjatë vizitave në institucion, vërejmë se UGJ-ja disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ. Kjo bazë e të dhënave gjendet pranë Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve

përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Ndihmësakadematike Administrative. Gjithashtu, referuar evidencave përkatëse dhe vizitave në institucion, konstatohet se të dhënat për angazhimin e personelit akademik në çdo vit akademik dhe semestër si dhe për planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik, si elemente të të dhënave personale, arkivohen pranë Njësisë bazë përgjegjëse. Po ashtu, sipas dokumentacionit të paraqitur në DVV, mbledhja, ruajtja dhe përditësimi për çdo vit akademik i këtyre të dhënave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik, GVI konstaton se në UGJ funksionon Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, i cili mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesëmarrjes në projekte kombëtare/ndërkombëtare, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e work shope. Duke iu referuar të dhënave të mbledhura si nga dokumentacioni përkatës, po ashtu edhe nga takimet me drejtuesit e njësive kryesore e bazë, personelin akademik e përfaqësues të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, konstatohet një numër shumë i ulët i mobiliteteve jashtë vendit dhe projekteve ndërkombëtare ku personeli akademik është i angazhuar.
	Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Nenet 41, 42 Evidenca 4.8. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA-së, nenet 4, 5; (Evidenca 4.9. Model dosje personeli). Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 46, gërma b; Evidenca 2.12. Rregullore e Njesisë bazë të gjuhës shqipe, Neni 14/Rregullore e Njesisë bazë të letërsisë, neni 14.; Evidenca 4.10. Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca 4.11. Model planifikimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik; Evidenca 4.8. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA-së, Neni 17; Evidenca 4.12. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me	Duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, konstatohet se plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" nuk përmban praktikë

institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	profesionale, të cilën ne e gjykojmë se tejet të rëndësishme dhe si e tillë, ajo duhet përfshirë si veprimtari brenda kuadrit të lëndëve të kategorisë D. Megjithatë, sipas po këtyre burimeve dhe pas takimeve të realizuara me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", konstatohet se njësitë bazë përgjegjëse angazhojnë stafin e tyre akademik për udhëheqjen e punimeve të diplomës dhe mbikëqyrjen e studentëve në terren të ekspedita gjuhësore dhe folklorike si veprimtari specifike sipas natyrës së programit të studimit. Evidenca 2.2. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", 2021-2024;
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Sipas evidencave të paraqitura në DVV, Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" nuk përmban praktikë profesionale. GVJ gjykon si tejet të domosdoshme realizimin e praktikës profesionale që duhet përfshirë si veprimtari brenda kuadrit të lëndëve të kategorisë D. Evidenca 2.2. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", 2021-2024;
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" i përmbush kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.</i> <i>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" është punësuar mbi bazën e të gjitha kriterëve dhe zotëron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. Shpërdarja e ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me kërkesat e programit mësimor dhe kualifikimeve shkencore të personelit akademik dhe jo gjithmonë në përputhje me bazën ligjore. GVJ vëren se PAE-të ndonjëherë duhet të realizojnë një ngarkesë mësimore vjetore edhe më të madhe se ajo që është parashikuar në aktet nënligjore në fuqi, kjo ndonjëherë edhe e papaguar.</i>



	GVJ konstaton mungesën e praktikës profesionale që nuk është e përfshirë si veprimtari brenda kuadrit të lëndëve të kategorisë D, dhe vëren se në informacionin e përcjellë përmes RVB-së dhe DVV-së në lidhje me aktivitetet ekstra kurrikulare në funksion të procesit mësimor, mungojnë të dhëna konkrete mbi marrëveshjet e arrira dhe aktivitetet e organizuara në kuadër të bashkëpunimeve me partnerë ndërkombëtarë. Po ashtu, vërehet mungesë e të dhënave mbi natyrën, llojin dhe mënyrën sesi zbatohen praktikisht këto bashkëpunime dhe marrëveshje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Pas vizitave në institucion, vërejmë se UGJ-ja, duke respektuar standardet e përcaktuara në V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre, siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Evidenca 4.2. V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017; Evidenca 4.3. Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024; Evidenca 4.13. Infrastruktura e UGJ-së; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Mjediset e Fakultetit/Njësi Bazë (Tabela 16)
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, pas vizitës në ambjentet e Universitetit të Gjirokastrës dhe bashkëbisedimit me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" vërejmë se për realizimin e këtij programi studimi, UGJ-ja garanton realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes

informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies në mjedise mësimore si klasa, laboratorë. Megjithatë, gjykojmë se ka vend për përmirësime në të ardhmen në lidhje me përdorimin e metodologjive teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Evidenca 3.13. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në Njësinë bazë të gjuhës shqipe/ njësinë bazë të letërsisë.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar evidencave dhe vizitës në ambjentet e UGJ-së, konstatohet se institucioni përpiqet të ofrojë kushtet dhe pajisjet e nevojshme të punës për të gjithë stafin në përputhje me rregulloret e brendshme dhe kuadrin ligjor. Gjatë vizitës në institucion vërejmë se auditorët në funksion të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" janë të përbashkëta në rang fakulteti. Po ashtu, konstatohet se ata kanë nevojë për rinovim dhe pajisje me mjetet e nevojshme për të realizuar një mësim efektiv të tilla si power point statik, tv me touch screen të lidhur me internet etj. Në fakt, vetëm pak prej tyre janë të pajisura me videoprojektorë në mënyrë që personeli akademik të jetë efektiv në kryerjen dhe përmbushjen e detyrës. Padyshim, është e rëndësishme që të rikonsiderohet financiarisht mundësia për modernizimin dhe përparimin teknologjik të aparaturave dhe mjeteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit Bachelor në 'Gjuhë dhe Letërsi Shqipe'. Evidenca 4.3. Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024; Evidenca 4.13. Infrastruktura e UGJ-së; Aneks-Tabelat përmbledhëse. Tabela 16.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Pasi shqyrtoi informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe pas vizitës në ambjentet fizike të universitetit, u konstatua se për realizimin e procesit mësimor, sipas kriterëve që përcakton kuadrin ligjor, Njësitë bazë të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" kanë në përdorim laboratorët e nevojshëm (për zhvillimin e gjuhës së huaj), sallë studimi, bibliotekë etj. Aneks-Tabelat përmbledhëse. Tabela 16.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se në funksion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, UGJ-ja ka vënë në dispozicion mjediset të përshtatshme në funksion të veprimtarisë mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit</i>

	<i>Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" dhe lëndëve të tij, si dhe në përputhje me standardet dhe normativat për infrastrukturën. Po ashtu, u konstatua se Njësitë bazë të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" kanë në përdorim, të përbashkëta në rang fakulteti, laboratorët e nevojshëm (për zhvillimin e gjuhës së huaj, sallë studimi, bibliotekë etj) për realizimin e procesit mësimor sipas kriterëve që përcakton kuadri ligjor. Megjithatë, ka vend për përmirësime në të ardhmen, në lidhje me përdorimin e metodologjive teknologjike bashkëkohore e inovative të mësimdhënies-mësimnxënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga GVB, vizitës në ambjentet e bibliotekës dhe bashkëbisedimit që GVJ pati me personelin akademik dhe grupin përfaqësues të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", vërejmë se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (gjuhë shqipe), fizike më së shumti, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Po ashtu, referuar sylabuseve mësimore të lëndëve, konstatojmë se literatura bazë dhe ndihmëse e lëndëve që i përkasin fushës së Gjuhësisë dhe Letërsisë përbëhet kryesisht nga tekste mësimore të botuara nga autoritete të mirënjohur shkencorë të Universiteteve publike, kryesisht Universitetit të Tiranës, ASA-së etj. Në të njëjtën kohë, konstatojmë se literatura e përdorur duhet të përditësohet me tituj e botime të reja në fushat përkatëse.
	Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, neni 11; Evidenca 2.22. Miratimi i literaturës bazë në njësitë bazë përgjegjëse 2022-2023; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet

	lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Pasi shqyrtimit të programeve lëndore dhe të literaturës së rekomanduar për shfrytëzim, konstatojmë se këto burime nuk ishin të përditësuara me botime të 10 dhe aq më pak të 5 viteve të fundit. Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Pasi mori në shqyrtim dokumentacionin përkatës dhe pas vizitës që GVJ realizoi në bibliotekën e UGJ-së, vërejmë se UGJ-ja ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, me tre salla leximi të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio vizive, duke garantuar në këtë mënyrë mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Po ashtu, konstatojmë se biblioteka disponon fond librash kryesisht në gjuhën shqipe dhe më të paktë në numër në gjuhë të huaj, në funksion të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Problematike paraqitet situata me përdorimin e librave elektronike ku studentët mund të shfrytëzojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj. Nga bashkëbisedimi që GVJ pati me studentët të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", konstatojmë se të paktë janë studentët që përdorin librarinë elektronike dhe literaturën në gjuhë të huaj. Rrjedhimisht, këshillojmë që të punohet më shumë për përmirësimin e kësaj sate dhe inkurajimin e studentëve drejt librave elektronike, që padyshim ofrojnë më shumë mundësi hulumtimi në fushat përkatëse. Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme	Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga GVB dhe bashkëbisedimit që GVJ pati me personelin akademik dhe grupin përfaqësues të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", si dhe me përfaqësues të bibliotekës së UGJ-së, vërejmë se literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare duke përfshirë tituj nga fusha të ndryshme studimi si shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre, gjuhësia, letërsia, historia,

dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	gjeografia, filozofia, psikologjia etj. Mbetet me interes, si nga ana e personelit akademik, po ashtu edhe nga ana e studentëve, pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës me tituj të ri, sidomos në gjuhë të huaj. Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga GVB dhe bashkëbisedimit që GVJ pati me personelin akademik dhe grupin përfaqësues të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", si dhe me përfaqësues të bibliotekës së UGJ-së, vërehet se UGJ-ja ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në shërbimin "on-line" të Bibliotekës "U-Library". [https://ulibrary.rash.al/]. Po ashtu, faqja zyrtare web e UGJ -së, (https://uogj.edu.al/biblioteka-online/), është vënë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve për të aksesuar "on-line", literaturë të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. Megjithatë, siç është parashtruar edhe më lart, nga bashkëbisedimi me studentët, numri i studentëve që përdorin bibliotekën online në gjuhë të huaj është shumë i vogël. Evidenca 4.17. Bibloteka, Manual përdorimi, Biblioteka Akademike; Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Pas vizitës në ambjentet e bibliotekës së UGJ-së dhe bashkëbisedimit me stafin akademik dhe përfaqësues të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", vërejmë se biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Investime më të mëdha në funksion të modernizimit të mëtejshëm të bibliotekës janë të nevojshme dhe të mirëpritura si nga stafi akademik, po ashtu edhe nga studentët. Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit	Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga GVB dhe bashkëbisedimit që GVJ pati me personelin akademik dhe grupin përfaqësues të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", si dhe vizitës institucionale në bibliotekën e UGJ-së, vërehet se biblioteka ofron shërbimin prej punonjësve të saj për studentët dhe

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	personelin akademik sipas orarit të afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrje të Bibliotekës. Evidenca 4.18. Rregullore e Bibliotekës; Evidenca 4.16. Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Pas vizitës në bibliotekë dhe bashkëbisedimit me personelin e angazhuar pranë saj, vërejmë se biblioteka përpiket të ndjekë dhe raportojë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online. Po ashtu, konstatojmë se duhet bërë më tepër për përditësimin dhe pasurimin e fondit fizik dhe atij online. Shtimi i numrit të titujve të disponueshëm online dhe rritja e fondit për porositjen e librave të printuar nuk do të ndikonte pozitivisht vetëm në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies, por edhe në performancën akademike të personelit. Evidenca 3.14. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit; Evidenca 4.19. Raportime nga biblioteka për NJBGJSH/NJBL-SË.
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se stafi akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", kanë në dispozicion bibliotekën e UGJ-së dhe sallat e leximit sipas orareve të afishuara. Literatura e ofruar aty është multidisiplinare, si në gjuhën shqipe, po ashtu edhe në atë të huaj. Gjithashtu, UGJ-ja ka vënë në dispozicion të studentëve edhe përdorimin e Bibliotekës online "U-Library" ku ata mund të shfrytëzojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj. Pasi shqyrtoi programet lëndore dhe literaturën e rekomanduar për shfrytëzim, GVJ konstaton se këto burime nuk ishin të përditësuara me botime të 10, dhe aq më pak, të 5 viteve të fundit.</i> <i>Problematike mbetet edhe numri i vogël i studentëve që përdorin bibliotekën online dhe që konsultojnë literaturë në gjuhë të huaj. Gjithashtu, gjatë takimeve në institucion, u ritheksua domosdoshmëria e pasurimit të bibliotekës me tituj të ri të literaturës shkencore e profesionale, sigurimi i të</i>



	cilëve, për arsye financiare, mbetet sfidë për të ardhmen. Modernizimi i infrastrukturës së bibliotekës në funksion të moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit është një tjetër sfidë për t'u konsideruar në vijim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në përputhje me Nenin 101 të Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutin e UGJ-së si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore) institucioni administron: Regjistrin themeltar të studentëve, Regjistrin e arritjeve akademike, Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, sistemin elektronik Pitagora, aplikacion softuerik i sekretarisë online, (https://uogj.pitagora.rash.al/login), si dhe sistemin elektronik i automatizimit të proceseve të sekretarisë mësimore dhe shërbimeve online për studentët ESSE3. Të gjitha këto elemente dëshmojnë për një sistem menaxhimi efikas për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 44, Evidenca 3.27. Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4, Evidenca 4.20. Urdhër për menaxhimin e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe	Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga GVB, Rregullores së FESHSH-së dhe vizitave në institucion, konstatohet se në UGJ, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretarit Protokoll realizon procesin e menaxhimit të dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ky informacion konsistonte në: 1. regjistrin themeltar, 2. dosjet personale të

partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	punonjësve, 3. librezat e punës së punonjësve dhe çdo dokumentacion tjetër të dhënë nga Rektori apo Administratori i Universitetit. Po ashtu, vërejmë se administrimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor, realizohet nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Krahas sektorëve të përmendur më lart, dokumentacioni që ka të bëjë me personelin akademik si: ngarkesën vjetore mësimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, programet lëndore etj. gjendej i arkivuar në FESHSH dhe NJBGJSH/NJBL. Evidenca 4.8. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA-së, Nenet 3, 4, 5., Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 82; Evidenca 4.10. Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca 4.11. Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili funksionon në bazë të rregullores përkatëse. Stafi akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin elektronik Pitagora [https://uogj.pitagora.rash.al/login] dhe në regjistrat e sekretarisë pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet dhe të dhëna të rezultateve gjatë viteve të studimit, të dhëna për personelin akademik, programet e studimit kurrikular, të dhëna financiare në lidhje me tarifat e studentëve dhe pagesat e kryera. Në sistemin Pitagora kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentet, i gjithë stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plan i mësimor, Struktura mësimore, Oraret mësimore etj. janë të publikuara edhe në faqen zyrtare web të UGJ -së. [https://uogj.edu.al/].



	Nga bisedat e realizuara me sekretarinë mesimore, studentët dhe stafin akademik, u evidentuan edhe problematika në lidhje me funksionimin e sistemit online të hedhjes së vlerësimeve të studentëve. Nga informacioni i vjelë nga sekretaria mesimore, konstatojmë se notat ruhen si në formatin elektronik, po ashtu edhe në procesverbal fizik të plotësuar manualisht. Po ashtu, ka raste kur sistemi online paraqet probleme të karakterit teknik dhe lipset që vlerësimi i studentëve të realizohet vetëm përmes procesverbaleve të plotësuara manualisht.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Bazuar në evidencat e plotësuara nga GVB, si dhe nga bashkëbisedimet me stafin akademik dhe studentët, vërejmë se format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve përfshijnë, përveç faqes web dhe postës elektronike zyrtare, edhe platformat elektronike si: Microsoft Office 365, Microsoft Teams etj. Megjithatë, këshillojmë që komunikimi përmes platformave online të jetë më masiv dhe produktiv në kuadër të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/; Evidenca 3.6. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përpiluar nga GVB, konstatohet se në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mesimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësisë së gjenerimit të raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultateve, pagesës së tarifës së studimit, monitorimit dhe afateve të hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Pas verifikimeve të kryera, GVJ-ja vëren se në faqen zyrtare web të UGJ-së, bazuar në Statutin e UGJ-së gjendet informacion në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UGJ-ja, programet mesimorë që ofron çdo fakultet sipas departamenteve, informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga UGJ-ja dhe fakultetet, stafin akademik, strukturën e vitit akademik, orari mesimor etj. Faqja zyrtare në web është në 2 gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.



	Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 60.; http://uogj.edu.al/.			
Konkluzione	<i>GVJ-ja verifikoi regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave dhe konstatoi se sekretaria mësimore administron, përpunon dhe arkivon të dhënat, procesverbaet dhe dokumentacion tjetër të nevojshëm në lidhje me cilësinë akademike të studentëve.</i> <i>Sistemi i menaxhimit të informacionit është më së shumti aktiv dhe efikas dhe u mundëson drejtuesve dhe titullarëve të institucionit komunikim të shpejtë në rang njësie bazë dhe asaj kryesore. Në UGJ menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari Protokollit.</i> <i>Pas verifikimeve të kryera, GVJ-ja gjithashtu vëren se në faqen zyrtare web të UGJ-së, bazuar në Statutin e UGJ-së, NJBGJSH-ja dhe NJBL-ja publikojnë: Informacione që lidhen me programin e studimit, Informacione mbi NJBGJSH-në dhe NJBL-në dhe personelin akademik të tyre, Informacione mbi aktivitete të ndryshme. Problematika e konstatuar nga GVJ-ja është mosfunksionimi i herë pas hershëm i sistemit online të hedhjes së vlerësimeve të studentëve sipas moduleve apo lëndëve përkatëse.</i> <i>Kështu, në rastet kur sistemi online paraqet probleme të karakterit teknik, vlerësimi i studentëve realizohet vetëm përmes procesverbaleve të plotësuara manualisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë	Sipas dokumentacionit të paraqitur në Dosjen e Vetëvlerësimit, Administratori i UGJ-së harton cdo vit një projekt buxhet vjetor të kostove të njësisë bazë përgjegjëse

përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Pas miratimit, buxheti i detajuar kalon për menaxhim në Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njëjësive. Evidenca 4.21. Propozim buxheti të FESHSH-së; Evidenca 1.2. Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025, Kreu Financat dhe Burimet Financiare, faqe 34; Evidenca 4.22. Projekt -Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit dhe evidencave të paraqitura, plani i financimit institucional përmban të dhëna për pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese, projektet dhe zëra të tjerë. Evidenca 4.23. Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.24. Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.25. Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS - Tabelat Përmbledhëse - Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18).
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se sipas kërkesave ligjore në fuqi, Raporti Financiar Vjetor në të cilin paraqiten të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, hartohet nga Drejtoria e Shërbimeve Universitare, duke vlerësuar në këtë mënyrë gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të institucionit. Gjithashtu, sipas evidencave të paraqitura, UGJ-ja, i nënshtrohet auditit financiar prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MAS, në mënyrë periodike.



	Evidenca 4.23. Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.24. Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.25. Raporti vjetor financiar për vitin 2022; Evidenca 4.26. Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve; Evidenca 4.27. Raport i MASR-së, AUDIT 2018; Evidenca 4.28. Raport i MAS-it, AUDIT, 2022.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Referuar Raporteve financiare të tre viteve të fundit të UGJ-së, GVJ vëren se Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori i UGJ-së raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës në Senatin akademik të UGJ-së dhe Bordin e Administrimit. Evidenca 4.23. Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.24. Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.25. Raporti vjetor financiar për vitin 2022.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në evidencat e dorëzuara, UGJ-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe administron fondet e veta financiare që rrjedhin nga të ardhurat dytësore. Me qëllim mirëmenaxhimit të këtyre fondeve dhe sigurimit të një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit. Evidenca 4.23. Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.24. Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.25. Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe pas vizitave institucionale në UGJ, GVJ konstatoi se UGJ-ja harton një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarrëvajtjen e programeve të studimit. Propozimet e bëra nga Njësitë Bazë dhe Kryesore reflektohen në projektbuxhetin e hartuar nga institucioni.</i> <i>UGJ-ja përpaket të hartojë planet buxhetore vjetore në përputhje me kërkesat, nevojat dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarrëvajtjen e programit të studimit. Në të ardhmen, me përmirësimin e situatës financiare, institucioni duhet të marrë në konsideratë ndërhyrje të nevojshme në</i>

	<i>diversifikimin e financimit të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar për shqyrtim në Dosjen e Vetëvlerësimit, vërehet se UGJ-ja harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Satutin e UGJ-së, rregulloret dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 62; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 49; Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 17; Evidenca 1.6. Rregullore e programit të studimit të Ciklit të parë Bachelor në



	"Gjuhë dhe letërsi shqipe", fq. 13. Evidenca 5.1. Udhëzim MAS-it Nr.12 datë 30.6.2023 Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL; Evidenca 5.2. Urdhër i përbashkët RASH-it dhe QSHA-së Nr 10 datë 10. 07. 2023, për miratimin e kalendarit 2023-2024; Evidenca 5.3. Miratimi i kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2021-2022 dhe miratimin e kuotave të pranimit për studentët për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 5.4. Miratimi i kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2022-2023 dhe miratimin e kuotave të pranimit për studentët për vitin akademik 2021-2022; Evidenca 5.5. Miratimi i kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2023-2024 dhe miratimin e kuotave të pranimit për studentët për vitin akademik 2022-2023; Evidenca 5.6. Vendimi i SA-së për miratimin e kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë, viti 2023-2024 dhe miratimin e kuotave të pranimit 2022-2023.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës: Statutit të UGJ-së, Rregullores së UGJ-së , Rregullores së FESHSH-së, GVJ konstatoi se aty gjenden në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nregjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikat e transferimit të tyre, gjithë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" Po ashtu, pas vëzhgimit të faqes zyrtare web të UGJ-së, konstatojmë se aty vazhdimisht publikohen informacione për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Këto informacione kanë më së shumti të bëjnë me kriteret dhe kuotat e pranimeve për çdo vit akademik, si dhe Rregulloret institucionale për ecurinë akademike të studentëve. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Evidenca 5.6.1. Dosja personale e studentit nga hyrja në diplomim, Evidenca 2.20. Procedurë e transferimit të studenteve; https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/; https://uogj.edu.al/statuti-i-

	universitetit/ ; https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/ .
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Dokumentacioni mbështetës që është vënë në dispozicion të GVJ-së sqaron mënyrën e përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Referuar këtij dokumentacioni, institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kështu, kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve dhe kuotat e pranimeve propozohen nga Njësitë Bazë dhe më tej, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati akademik duke respektuar afatet dhe kërkesat sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evidenca 5.3. Miratimi i kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2021-2022 dhe miratimin e kuotave të pranimit për studentët për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 5.4. Miratimi i kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2022-2023 dhe miratimin e kuotave të pranimit për studentët për vitin akademik 2021-2022; Evidenca 5.5. Miratimi i kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2023-2024 dhe miratimin e kuotave të pranimit për studentët për vitin akademik 2022-2023; Evidenca 5.6 Vendimi i SA-së për miratimin e kriterëve të pranimit për studentët e ciklit të parë, viti 2023-2024 dhe miratimin e kuotave të pranimit 2022-2023.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Fakultetit dhe Rregullorja e studimeve, dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome. Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen web të Universitetit të Gjirokastrës. Në takimin me studentët, konstatohet se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion dhe me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. Po ashtu, në rregulloret përkatëse, përcaktohen procedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca 2.5.

	Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Kreu IV, Kreu V, Kreu VI, Kreu VII.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar te informacioni i paraqitur në DVV dhe i konfirmuar nga vizita në institucion, konstatojmë se në UGJ ushtron veprimtarinë e saj Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, e cila në bashkëpunim me Fakultetin e FESHSH-së dhe NJBGJSH-në dhe NJBL-në, realizojnë komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programeve të studimit. Mjetet kryesore që përdoren më së shumti për këtë qëllim janë: 1. Faqja web e UGJ-së, cila publikon periodikisht informacione rreth programeve të studimit, përmbajtjes së tyre, diplomave që ofron dhe mundësive të punësimit, kriterëve të përgjithshme e të veçanta për ndjekjen e tyre etj. 2. Takimet promovuese, me nxënës maturantë të shkollave të mesme. 3. Rrjetet sociale. 4. Mediat lokale. 5. Fletëpalosjet dhe posterat Evidenca 5.5. Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca 3.21. Pjesëmarrje ne Panair Work and Study 2022, Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca 5.11. Kalendari i ditëve të këshillimit të karrierës; Evidenca 5.11.1. Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca 5.11.2 Fletëpalosje UGJ.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar te informacioni i paraqitur në DVV dhe i konfirmuar nga vizita në institucion, UGJ parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS. Evidenca 5.12. Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; Evidenca 5.5. Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca 5.1. Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-IAL
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e	Dokumentacioni i paraqitur për shqyrtim evidenton se UGJ-ja dhe Departamentet përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në 'Gjuhë dhe Letërsi shqipe' hartojnë dhe publikojnë përpara çdo viti akademik kriteret për

kandidatëve nga shtete të tjera.	përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera, kryesisht nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqipfolëse të shteteve të tjera si Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë (Serbi) dhe të Huaj, të cilët janë të interesuar për të ndjekur srudimet. Këto kritere janë përputhje me aktet nënligjore të MAS. Evidenca 5.12. Kuotat e pranimi viti akademik 2023 - 2024; Evidenca 5.5 Kriteret e pranimi për vitin akademik 2023-2024; Evidenca 5.1. Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-IAL
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në DVV dhe pas bashkëbisedimit me studentët e programit të studimit Bachelor në 'Gjuhë dhe letërsi shqipe', konstatohet UGJ-ja zbaton politikat e saj të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë si dhe për studentët ekselentë në varësi të arritjeve akademike duke synuar rritjen e cilësisë së pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Evidenca 2.6. Vendime të Bordit të Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca 2.6.1. Vendim Rektorati dhe Senati Akademik për heqjen e taksës së shkollimit për aplikantët që regjistrohen në programet Bachelor që pasohen nga programet Master në mësuesi për vitin akademik 2021-2022, Evidenca 5.13. VKM-ja nr.386, datë 1.6.2022.
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se hartimi i programit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", pranimi i studentëve në këtë program studimi dhe përzgjedhja e kritereve të pranimi për kandidatët me status të veçantë janë kryer në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr 80/2015 si dhe në aktet rregullatore në fuqi. UGJ informon të interesuarit në lidhje me kriteret e përcaktuara për aplikimet në të gjitha programet e studimit. Në Rregulloren e UGJ-së, Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FESHSH-së përshkruhen kriteret e pranimi dhe përzgjedhjes, ecuria akademike, procesi i transferimit dhe kriteret dhe procedurat e diplomimit.</i> <i>Po ashtu, nëpërmjet vendimarrjeve dhe procedurave përkatëse institucionale, UGJ-ja zbaton politikat e saj të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë si dhe për rritjen e cilësisë së pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar te dokumentacioni i paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë, konstatohet se studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre, informohen në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin, procesin mësimor, planin mesimor, strukturën mësimore, orarin mësimor, pedagogun e lëndës etj. Të dhëna të kësaj natyre gjenden hollësiht të shpjeguara në Rregulloret institucionale, të publikuara në ambjentet e FESHSH-së si dhe në faqen zyrtare web të UGJ-së. (https://uogj.edu.al/) dhe dhe studentët kanë akses në çdo kohë. Studentët konfirmojnë që në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve programet lëndore (syllabuset), procedurat për përparimin akademik, detyrimet mbi frekuentimin e lëndës, format e kontrollit të dijeve të fituara dhe vlerësimit të studentëve etj. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI, VII; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca 2.5. Rregullore e Fakultetit të FESHSH-SË, Kreu V, VI, VII.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës, GVJ konstatoi se të gjitha procedurat e kryera në kuadër të informimit të studentëve mbi kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme janë në përputhje me rregulloren e institucionit, të cilat bazohen edhe rregulloret e tjera të Njësive bazë dhe kryesore. Studentët informohen përmes sekretarisë mësimore në lidhje me procedurat përkatëse. Për njohjen dhe ekuivalentimin e lëndëve mësimore nga programi i mëparshëm i studimit në

	programin e studimit në UGJ, në departamentet përgjegjëse ngrihet një komision i posaçëm i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacion i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 72; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 65; Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-SË, Nenet 30, 31; Evidenca 5.14. Ekuivalentim lëndesh mësimore Gjuhë dhe Letërsi; Evidenca 2.20. Procedurë e transferimit të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar te dokumentacioni i paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë, GVJ konfirmoi se studentët në fillim si dhe gjatë vitit akademik informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e lëndës dhe provimi final. Vlerësimi i vazhduar përfaqëson 20% të vlerësimit përfundimtar. Testimi final bëhet në përfundim të lëndës dhe zhvillohet si provim me shkrim. Numri i pyetjeve (pyetje teorike ose ushtrime) që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i lëndës, numri i leksioneve dhe seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje teorike dhe /ose ushtrime që vlerësohen në total me 80 pikë. Studentët ishin në dijeni të procedurave dhe kriterëve të mësipërme dhe ishin relativisht të kënaqur me këtë sistem vlerësimi. (Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI, VII; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca 2.5. Rregullore e Fakulteti e FESHSH-SË, Kreu V, VI, VII; Evidenca 1.7.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Bazuar te informacioni i dorëzuar në DVV, mbështetur në Rregulloren e Studimeve në UGJ, Rregulloren e UGJ-së, në Rregulloren e FESHSH-së si dhe planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, studentët në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Është nota mesatare ajo që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Pas marrjes së vendimit nëse studenti diplomant do të hartojë punim diplome apo do t'i nënshtrohet provimit të

	përgjithshëm përfundimtar, atij i vihen në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të punimit të diplomës ose të provimit. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenin 93, Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 61; Evidenca 3.23. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve. Evidenca Plan mësimor Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” , 2021-2024.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Referuar dokumentacionit mbështetës në DVV, UGJ-ja organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e maturantëve dhe të interesuarve mbi programet e studimit në UGJ. Institucioni periodikisht merr pjesë në Panairin Work and Study, ku realizohet reklamimi i programeve të studimit që UGJ-ja ofron dhe informimi i studentëve të ardhshëm rreth tyre. Po ashtu, spotet televizive dhe fletëpalosjet promovuese janë disa mjete të tjera interesante që institucioni përdor për afrimin dhe tërheqjen e studentëve potencialë në të ardhmen. Megjithatë, duke marrë në konsideratë numrin shumë të ulët të studentëve aktualë, duhen gjetur metoda dhe mjete më interesante për përthitjen e tyre. Evidenca 3.21. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca 5.11. Fletëpalosje, Universiteti.
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se institucioni, Njësitë bazë e kryesore, sekretaria dhe Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar dhe faqja web e institucionit ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</i> <i>Po ashtu, studentët janë informuar në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit., duke përfshirë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe përmirësimin e notës. Përmbyllja e studimeve në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” realizohet me provim të</i>

	<i>përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, në varësi të notës mesatare gjatë viteve të studimeve të studentvë.</i> <i>Studentët pohuan se kishin marrë informacion të detajuar dhe ishin orientuar qartë nga stafi akademik në lidhje me fondin e pyetjeve të provimit të formimit dhe punimin e diplomës sipas rregulloreve dhe manualeve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Bazuar te dokumentacioni i paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë, konstatohet se në fillim të çdo viti akademik, studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes Departamenteve përgjegjëse, Sekretarise Mësimore dhe faqes së Web-it, ato gjejnë informacionet e duhura për të gjitha elementet përbërëse të studimeve të tyre. Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI, VII; Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, fq.2.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, u konfirmua nga studentët se atyre iu ishte vënë në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentacioni udhëzues si Rregulloren e programit të studimit, plani mësimor me lëndët përkatëse, programet lëndore, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të tyre etj. Ky informacion i detajuar gjendet edhe në faqen zyrtare web të UGJ-së www.uogj.edu.al. Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”; Evidenca 2.2. Plan mësimor Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, 2021-2024; ANEKS. Tabela përmbledhëse. Tabela nr.14.

	Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" 2022-2023.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Referuar dokumentacionit mbështetës të dorëzuar në DVV, UGJ-ja merr pjesë në Panairin e Punës, me qëllim informimin e studentëve për tregun e punës dhe punëdhënës të ardhshëm potencialë. Për promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit shërbejnë edhe Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, e cila së paku në letër listojnë një sërë marrëveshesh bashkëpunimi, projekte dhe mobilitete. Vlen të përmendet që, fatkeqësisht, një pjesë e mirë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve dhe mobiliteteve kanë vetëm karakter formal dhe nuk janë vënë asnjëherë në zbatim praktikisht. Evidenca 3.21. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca 4.8. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA-së, Neni 14; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23); Evidenca 1.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve dhe mobiliteteve të UGJ-së.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Pas takimeve me studentët gjatë vizitës institucionale, u pohua nga ata, se përgjegjësit e Njësive bazë, sekretaria mësimore, stendat e informimit, faqja zyrtare web dhe rrjetet sociale shërbejnë si mjete efikase për përcimin dhe përthithjen e informacioneve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën etj.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Pas takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore, u konfirmua se faqja zyrtare web e UGJ-së, www.uogj.edu.al : posta zyrtare elektronike si dhe sistemi i sekretarisë mësimore https://uogj.pitagora.rash.al/login u mundësojnë studentëve informacioni që është lehtësisht i arritshëm nga ata. Ky i fundit, sipas sekretarisë, stafit akademik dhe studentëve ndonjëherë paraqet ndonjëherë probleme me karakter teknik, të cilat vështirësojnë procedurat përkatëse.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se studentët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" janë informuar mbi kurrikulat,</i>



	rregulloren e programit të studimit, formën e studimit, kreditet, kohëzgjatjen e studimeve, ngarkesën në auditor, frekuentimin dhe format e vlerësimit, infrastrukturën dhe logjistikën. Studentët pohuan se ata informoheshin rregullisht dhe udhëzoheshin në mënyrë të detajuar nga personeli akademik mbi lëndët, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese. Shumë prej informacioneve ishin lehtësisht të aksesueshme edhe në faqen e web-it www.uogj.edu.al. Problematika konstatohen në sistemin e sekretarisë mësimore https://uogj.pitagora.rash.al/login, i cili, sipas sekretarisë, stafit akademik dhe studentëve ndonjëherë paraqet probleme me karakter teknik, që mund të vështirësojnë procedurat përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton se UGJ-ja përmes sekretarisë mësimore dhe Specialistit të Statistikës kanë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për cdo program studimi. Sekretaria ka: – Regjistrin themeltar të studentëve – Regjistrin e lëshimit të diplomave – Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave). Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 92; Evidenca 3.27. Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); Evidenca 5.15. Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet, VITI 2019-2020; 2020-2021; ANEKS-Tabela përmbledhëse. Tabela 23.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore	Gjatë vizitës në institucion, vërejmë se UGJ-ja ka të dhëna statistikore vjetore për numrin e studentëve të regjistruar,

për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	klasifikimin e studentëve të rinj në programet e studimeve sipas gjinisë, grupmoshave dhe vendbanimeve, cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, për studentët e diplomuar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit etj. Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezultoi që numri i studentëve për këtë program studimi në tre vitet akademike është si më poshtë vijon Viti akademik 2020-2021... 5 studentë Viti akademik 2021-2022... 6 studentë Viti akademik 2022-2023... 14 studentë Evidenca 1.16. Raporti vjetor UGJ-së, viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve Tabela 21; Evidenca 5.16. Lista e të transferuarve dhe të larguarve nga UGJ-ja.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ, në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore, inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh për këtë funksion. Të dhënat statistikore të studenteve menaxhohen manualisht dhe elektronikisht nëpërmjet Sekretarisë Mësimore (sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora). Këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahe vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Megjithatë, siç është përmendur edhe më lart, probleme të karakterit teknik janë konstatuar në sistemin elektronik Pitagora, gjë që ka vështirësuar procedurat përkatëse. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 92, pika 3; Evidenca 4.12. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë	UGJ-ja ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse që lidhen me organizimin e punës kryejnë kontrole periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive



gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	mesimore dhe departamenteve ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar. Evidenca 5.17. Kontroll dokumentacioni viti akademik 2018-2019; Evidenca 5.18. Kontroll dokumentacioni viti akademik 2021-2022.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në Raportet Vjetore të Njësive bazë, Raportet Vjetore të Fakulteteve, në raportime të Sekretarive mësimore, Drejtorisë së Shërbimeve Akademike-ndihmës akademike (Zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar), institucioni harton Raportin Vjetor Institucional ku përfshihen veprimtaria mësimore dhe shkencore, ecuria e programeve të studimit, informacione për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Evidenca 1.16. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se sekretaria mësimore dhe strukturat e menaxhimit të brendshëm të informacionit monitorohen dhe vlerësohen periodikisht nga institucioni me qëllim përmirësimin e punës dhe funksionimin e tyre. Institucioni ruan dhe dokumenton statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve, si dhe tërheqjet dhe largimet nga këto programe studimi. Sekretaria mësimore ruan statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në secilin program studimi.</i> <i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen manualisht dhe elektronikisht nëpërmjet Sekretarisë Mësimore (sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora). Problematika shfaqen me menaxhimin e sistemit elektronik Pitagora, i cili, për shkak të problemeve më karakter teknik, ka vështirësuar procedurën e hedhjes elektronike të vlerësimeve. Në këto</i>



	<i>rrethana, është praktikuar hedhja e vlerësimeve vetëm manualisht dhe më tej është realizuar arkivimi i procesverbaleve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UGJ-së. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik të UGJ-së, në Këshillin e Etikës, në Këshillin Studentor janë të përfaqësuar në Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë. Një studente ka qenë pjesmarrëse aktive dhe në hartimin e RVB-së. Gjatë bashkëbisedimit me studentët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", konstatohet se studentët kanë fare pak dijeni mbi veprimtarinë dhe përfaqësimin e tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të UGJ-së. Po ashtu, jo rrallë herë ata nuk shprehin interes në mënyrën e funksionimit të këtyre organeve. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 18, Neni 24; Evidenca 2.25 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik, Evidenca 5.19. Rregullore e organizimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor; Evidenca 2.26.1 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor; Evidenca 2.26. Statuti i Këshillit Studentor), ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Të dhëna për anëtarët e NJBSC-së (Tabela 24), Evidenca 5.20. Statuti i Shoqatës sportive "E. Çabej", Gjirokastër; Evidenca 5.21. Kërkesë për mbështetje financiare për Shoqatën sportive studentore.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se	Referuar dokumentacionit mbështetës të dorëzuar për shqyrtim, vërejmë se studentët përfaqësohen ose janë pjesë e

përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	organeve në nivel institucional dhe në organe në nivel njësie kryesore. Kështu, studentët përfaqësoheshin në Senatin akademik të UGJ-së në masën 10%. Ata janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës, janë anëtarë të komisioneve zgjedhore institucionale, ata organizohen lirisht në Këshillat Studentore, institucionale dhe në njësi kryesore, janë anëtarë të Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional si dhe Akreditimin e programeve të studimit, si dhe pjesë aktive e sondazheve vjetore të studentëve organizuar nga ASCAL-i dhe e sondazheve të organizuar nga UGJ-ja. Gjatë takimit që studentët zhvilluam me GVJ-në, shumë pak prej tyre ishin në dijeni të përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të UGJ-së. Po ashtu, ata kishin pak njohuri në lidhje me propozimet e bëra nga përfaqësuesit e tyre në këto organe për programet mësimore, rregulloret e ndryshme etj. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni 88, pika 1 gërma b, Neni 91, pika 5, Neni 18, pikat 2, 3; Evidenca 2.25. Lista e anëtarëve të Senatit Akademik; Evidenca 5.22. Rregullore e zgjedhjeve të 2020, në UGJ; Evidenca 5.23. Vendimet e KIZ-it për zgjedhjet në UGJ; Evidenca 2.26.1. Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor; Evidenca 2.26. Statuti i Këshillit Studentor); Evidenca 5.24 Vendimi i FESHSH-së-së nr. 3, datë 13.4.2023 për miratimin e grupeve të vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programeve të studimeve në FESHSH; Evidenca 5.24.1 Vendimi nr.2,5.4.2023, Për miratimin e GVB-së në njësinë bazë të gjuhës shqipe dhe njësinë bazë të letërsisë. Evidenca 5.25. Vendimi i SA-së nr. 26.datë 28.9.2023 Për miratimin e grupeve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë sipas programeve të studimit; Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 24, pika 3; Evidenca 3.19. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës; ANEKS-TABELAT PËRMbledhëse-Të dhëna për anëtarët e NJBSC-së Tabela 24.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe	Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të mësimdhënies realizohet përmes pyetësorëve që u drejtohen atyre. Sipas evidencave të dorëzuara në DVV, rezultatet dhe sugjerimet e marra nga procesi i anketimit të studentëve pasqyrohen në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të përgatitur nga Njësia e Brendshme e Sigurimit

reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	të Cilësisë. Raporti diskutohet më pas në NJB-të, nga ku jepen sugjerimet konkrete për përmirësimin e rezultateve të matura. Evidenca 3.16. Urdhër nr. 16, datë 25.3.2022 për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë; Evidenca 3.16.1. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për periudhën e mësimi on-line.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Kuadri Rregullator i UGJ-së u siguron studentëve të drejtën për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të kontrollit të dijeve, si dhe për të kërkuar rishikim apo rivlerësim. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me rregulloren atëherë me propozim të Përgjegjës të njësisë bazë, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënien e provimit. Gjatë takimit me studentë të programit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", studentët u shprehën se njihnin mirë procedurën e ankimimit, rishikimit dhe vlerësimit të vlerësimit përfundimtar. Megjithatë ata u shprehën se nuk kishin patur ndonjë pakënaqësi në lidhje me vlerësimin e tyre përfundimtar në lëndë të ndryshme. Studentët e këtij programi studimi u shprehën se vlerësimi i tyre ka qenë gjithmonë objektiv, i pranueshëm dhe i kënaqshëm për ta. Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Kreu VII; Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-SË, Kreu VI, VII; Evidenca 2.12. Rregullore e njësisë bazë të gjuhës shqipe/njësisë bazë të letërsisë, fq.12; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Kreu V) (Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 46).
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se formalisht studentët e UGJ-së gëzojnë të drejtën e përfaqësimit në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit si: Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor dhe në Grupe të Vlerësimit të Brendshëm.</i> <i>Megjithatë, nga takimi me studentët, u konstatua se studentët kishin fare pak njohuri në lidhje me përfaqësuesit e tyre në këto organe vendimmarrëse e këshilluese dhe me propozimet apo angazhimin e tyre praktik. Madje, ata as nuk ishin në gjendje të përmendnin ndonjë problematikë që mund të ngrinin për diskutim në këto organe për përmirësimin e programit të studimit dhe për çështje të tjera në interes të tyre.</i>



	Gjatë të njëjtit takim, GVJ vëren se studentët e njihnin mirë procedurën e ankimimit, rishikimit dhe vlerësimit të vlerësimit përfundimtar. Për më tepër, ata u shprehën se vlerësimi i tyre ka qenë gjithmonë objektiv, i pranueshëm dhe i kënaqshëm për ta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Referuar dokumentacionit të plotësuar nga GVB, UGJ-ja ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë: – Zyra e Alumni dhe Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, – Sekretaria mësimore, e cila është e hapur çdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim, – Dejtoria e Shërbimeve Universitare, Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë – Zyra e IT-së, Njësitë bazë, faqja zyrtare e web-it, rrjetet sociale. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 42; Evidenca 4.8. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA-së, Neni 14, Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Nenet 42, 43, 44.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Referuar evidencave të përpiluara nga GVB dhe takimit me studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, u konstatua se institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”.

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në institucion funksionon Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar ku studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme për: – Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë, – Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune, – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës, – Identifikimin e aftësive dhe shprehive etj. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 42; Evidenca 4.8. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA-së, Neni 14.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe pas vizitave institucionale, GVJ vëren se Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar përpunon të mbajë lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data -bazë të të dhënave të cilat përditësohen cdo vit. Lipset që zhvillimi i pyetësorëve të ndryshëm, veçanërisht të atyre ALUMNI, të praktikohet më shpesh me qëllim gjurmimin e të diplomuarve dhe punësimin e tyre pas mbarimit të ciklit të studimeve. Gjithashtu, vihet re se pyetësorët duhet të jenë jo vetëm më të shpeshtë, por edhe më të elaboruar e të plotë duke marrë në konsideratë një kampion më të lartë në numër studentësh. Po ashtu, është e domosdoshme të realizohet përpunim më i saktë e i qartë i të dhënave të gjeneruara.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se informimi dhe mbështetja e studentëve realizohet përmes Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative dhe Sektorit të Shërbimeve Biblotekare Arkivore dhe Studentore, nëpërmjet zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, Sekretarive mësimore, Zyrës së IT-së, Dejtorisë së Shërbimeve Universitare, Njësive bazë e kryesore, Faqes së web të UGJ-së etj.</i> <i>Pavarësisht punës deri diku të kënaqshme të bërë nga këto organizma, GVJ gjykon se sondazhet e pyetësorët e zhvilluar nga orgaznizamt përgjegjës duhet të jenë më të shpeshtë, më</i>



	<i>gjithëpërfshirës, më të mirëstrukturuar dhe të dhënat e grumbulluara të jenë më të plota, të qarta dhe të sakta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një proces i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. Referuar të dhënave të analizuara në RVB dokumentacionit mbështetës në DVV dhe pas vizitës institucionale, vërejmë se UGJ-ja në nivel institucional i ka kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies sidomos gjatë periudhës së pandemisë së Covid 19, kur UGJ-ja ofroi alternativën online të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet platformave elektronike të mësimin të distancë, Office 365 dhe Microsoft Teams. Megjithatë, pas vizitave në institucion dhe bisedave me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se të tilla metoda inovative nuk përdoren më, me stabilizimin e procesit mësimor pas pandemisë. Këshillojmë që platofrmat online dhe mjete të tjera teknologjike e moderne të jenë në funksion të procesit mësimdhënës dhe mësimnxënës si ura lidhëze komunikimi të vazhduar mes stafit akademik dhe studentëve. Evidenca 3.1. Urdhër për platformën e mësimin online; Evidenca 3.2. Implementimi i platformës së mësimin online

	Classroom; Evidenca 3.3. Implementimi i platformës së mesimit online Edumeet; Evidenca 3.4 Implementimi i platformës së mesimit online Office 365; Evidenca 3.6. Manual përdorimi të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët; Evidenca 3.10. Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021; Evidenca 3.8. Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.9. VendimSenati për miratimin e rregullores së provimeve2020-2021;Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Duke iu referuar dokumentacionit mbështetës në DVV, monitorimi i vazhdueshëm, vlerësimi dhe promovimi i cilësisë së veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore realizohet nga SSCK-ja, organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Gjithashtu, referuar RVB-së, në UGJ funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë (NJSBC), e cila mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë (https://uogj.edu.al/kod-cilesise/) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë, është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ konstatoi se dokumentacioni mbështetës i paraqitur në DVV, konsiston vetëm në një vendim për ngritjen e NJSBC-së dhe një vendim tjetër për miratimin e NJSBC-së. Rrjedhimisht, GVJ gjykon se NJSBC është një njësi në strukturim e sipër, e cila duhet të mirëorganziohet dhe të funksionojë më me efikasitet në të ardhmen, duke përmbushur kështu misionin real të saj. Po ashtu, pyetëtorët e zhvilluar me studentët në funksion të përmirësimit të procesit të edukimit duhet të jenë periodikë, me pjesëmarrje më të lartë, duke gjeneruar të dhëna më të sakta e më të qarta. Evidenca 3.16. Urdhër nr. 16. datë 25.3.2022, Për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë; Evidenca 3.16.1. Raport i pyetësorit për procedurën e mesimit online; Evidenca 2.27. Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së programeve të ofruara nga UGJ-ja; Evidenca 1.16. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022;

	Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së 2021-2022; Evidenca 6.1. Vendimi nr. 38, datë 9.12.2020 për ngritjen e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë në UGJ; Vendimi nr. 24, datë 28.9.2023 për miratimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë në UGJ.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Bazuar në RVB, UGJ-ja garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve nëpërmjet: pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, përfaqësimit të tyre në organet në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore. Gjatë bashkëbisedimit me studentët, GVJ-ja vëren se studentët reflektojnë indiferentizëm dhe mangësi njohurish në lidhje me përfaqësimin e tyre në organe vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Ata, madje, në të shumtën e rasteve, nuk njohin as përfaqësuesit e tyre në organet këshilluese dhe drejtuese institucionale. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, ; Evidenca 2.1. Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 46; Evidenca 5.24. Urdhër për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RBV dhe dokumentacionit mbështetës që gjendet në DVV dhe duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 103: "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë", SSCK-ja duhet të hartojë dhe bëjë publike rezultatet e vlerësimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, së bashku me rekomandimet përkatëse. Në UGJ, SSCK-ja duke qenë një strukturë në organizimin e sipër, bashkë me NJSBC-në, këshillojmë që të bashkërendohet më mirë puna dhe misionet e tyre për mirëfunksionim dhe efikasitet të të gjithë procesit. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5, gërma h, i Evidenca 3.16.1 Raport i pyetësorit për procedurën e mësimin online; UGJ-ja nëpërmjet faqes zyrtare web [https://uogj.edu.al/transparenca/Evidenca 6.3. Vendimi i SA-së, nr. 52, 16.12.2021, Për miratimin e programit të transparencës në UGJ, 2021; Evidenca 6.4. Vendimi SA-së, nr.21, 16.5.2023, Për

	miratimin e programit të transparencës së rishikuar në UGJ; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së 2021-2022), Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të NJBGJSH-SË, 2021-2-22; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore -shkencore të NJBL-SË, 2021-22;
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në analizën e bërë në RVB dhe evidencat përkatëse, pjesë e DVV-së, GVJ konstatoi se UGJ-ja përdor mekanizma të vlerësimit, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo evidentohet në Raportet vjetore mbi veprimtarinë mësimore kërkimore, të cilat shërbejnë si instrument i rëndësishëm për përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik. Megjithatë, gjejkojmë se mund të arrihet më tepër si në nivel institucional, po ashtu edhe në atë personal akademik, në zhvillimin dhe përdorimin e metodave e teknikave bashkëkohore të mësimdhënies në varësi të fushës së studimeve e lëndëve/moduleve. Evidenca 3.16.1. Raport i pyetësorit për procesin e mësimin online; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së 2021-2022; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të NJBGJSH-SË, 2021-2-22; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore -shkencore të NJBL-SË, 2021-2-22.; Evidenca 3.12. Vendim i SA-së, nr.37, datë 14.11.2022 për miratimin e strategjisë për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në IAL, 2023-2028;
	Evidenca 3.11 . Metoda inovative të mësimdhënies.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti i Gjirokastrës ka ngritur struktura dhe drejtori me qëllim ndjekjen e një politike të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies tilla si: Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK), Njësia</i>



e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë (NJSBC) dhe Grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit.

Bazuar në dokumentacionin mbështetës të dorëzuar në DVV, GVJ gjykon se NJSBC është një njësi në strukturim e sipër, e cila duhet të mirëorganziohet dhe të funksionojë më me efikasitet në të ardhmen, duke përmbushur kështu misionin real të saj, objektivave dhe qëllimeve që ajo duhet të plotësojë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

GVJ konstatoi se UGJ-ja, bazuar në dokumentacioni përkatës, garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve nëpërmjet: pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, përfaqësimit të tyre në organet në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore.

Ndërkohë, praktikisht, studentët e programit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", studentët reflektojnë indiferentizëm dhe mangësi njohurish në lidhje me përfaqësimin e tyre në organe vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit.

Njëkohësisht, GVJ-ja gjykon se mund të arrihet më tepër si në nivel institucional, po ashtu edhe në atë personal akademik, në zhvillimin dhe përdorimin e metodave e teknikave bashkëkohore të mësimdhënies në varësi të fushës së studimeve e lëndëve/moduleve.

Ky kufizim kompensohet në një farë mënyre në kuadrin rregullator të institucionit, i cili, në mënyrë të tërthortë jep udhëzimet përkatëse në lidhje me përdorimin me efikasitet i teknikave dhe metodologjive inovative në mësimdhënie.

Shkalla e përmbushjes së standardit

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në Statutin e UGJ-së përcaktohen qartë politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në rang Universiteti. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë. Në RVB gjejmë evidenca të vendimeve, rregulloreve dhe funksionit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të cilësisë (NJSBC) dhe SSKC-së. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 94) si dhe Rregulloren e NJSCB-së; Evidenca 6.2. Rregullore e NJSCB-së, neni 5,6,7, Evidenca 6.2. Rregullore e NJSBC-së; Evidenca 1.2 Strategjia e zhvillimit të UGJ-së 2020-2025; Evidenca 3.16.1 Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online; Evidenca 2.27. Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së programeve të ofruara nga UGJ-ja; Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së, 2021-2022. Evidenca 1.16. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore -shkencore të NJBGJSH-SË, 2021-2-22; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore -shkencore të NJBL-SË, 2021-2-22;
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në RVB, citohet se si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. Evidenca 1.21. Lista e Marreveshjeve të bashkëpunimit, projekteve dhe mobiliteteve të UGJ-së; Evidenca 3.21. Pjesëmarrje në Panair work and Study 2022; Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023. Bazuar në dokumentacionin relativisht të varfër në sasi dhe në përmbajtje, në lidhje me organizimin e funksionimit të NJSBC-




	së dhe SSKC-së, të dorëzuar si pjesë e DVV-së, dhe gjatë takimeve me përfaqësues të organizmave përkatëse në UGJ, konstatojmë se NJSBC është strukturë formalisht e ngritur rishtazi, dhe, si e tillë ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Ajo duhet të mirëorganizohet dhe të funksionojë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga vizita në institucion dhe nga bashkëbisedimet me përfaqësues të këtyre njësive dhe zyra, vërejmë se Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe të Kurrikulave zbaton procedurat dhe urdhrat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, por nuk harton politika dhe nuk ka kompetenca për miratimin e instrumentave matëse të procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit të stafit akademik. Po ashtu, GVJ gjykon se sondazhet apo pyetësorët, si instrumenta matëse dhe vlerësuese të mirëfillta të cilësisë së mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike, duhet të jenë më të shpeshtë, më të mirëstrukturuara, duke garantuar kështu një pjesëmarrje më gjithëpërfshirëse dhe duke mundësuar gjenerim më të saktë, të qartë e të plotë të të dhënave të grumbulluara. Përpunimi më i drejtë i të dhënave do të çontë në identifikimin e problematikave dhe hartimin e politikave dhe praktikave të duhura për zgjidhjen e tyre dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe aktivitetit kërkimor-shkencor.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Referuar RVB-së dhe dokumentacionit mbështetës, në funksion të sigurimi të cilësisë UGJ-ja ka realizuar procesin e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë. UGJ-ja ka marrë akreditimet periodike institucional, me Vendim Nr.67, datë 21.09.2017 dhe Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL-it, ku akreditimi ka një afat 4 vjeçar. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm deri tani. https://uogj.edu.al/vendim-i-ba-dhe-crtifikata-e-akreditimit/; Evidenca 1.8. Vendim nr. 55. datë 16.12.2021, Akreditimit Institucional periodik.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën	Referuar RVB-së, SSKC-ja bazuar në Statutin e UGJ-së, kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore, organizon pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi dhe raportin të dhënat në raporte. Siç përmendet edhe më sipër, GVJ-ja gjykon se sondazhet apo pyetësorët, si instrumenta matëse dhe vlerësuese të mirëfillta të cilësisë së mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike, duhet të jenë më të shpeshtë, më



promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	të mirëstrukturuar, duke garantuar kështu një pjesëmarrje më gjithëpërfshirëse dhe duke mundësuar gjenerim më të saktë, të qartë e të plotë të të dhënave të grumbulluara. Përpunimi më i drejtë i të dhënave do të çonte në identifikimin e problematikave dhe hartimin e politikave dhe praktikave të duhura për zgjidhjen e tyre dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe aktivitetit kërkimor-shkencor. Evidenca 3.16.1. Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së, 2021-2022; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore -shkencore të NJBGJSH-SË, 2021-2-22; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore -shkencore të NJBL-SË, 2021-2-22.
Konkluzione	<i>Nga dokumentacioni mbështetës në DVV dhe takimet në institucion me strukturat përgjegjëse, GVJ-ja konstaton se institucioni me të cilin UGJ ka bashkëvepruar për Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë, sipas parashikimit në ligjin për Arsimin e Lartë nr 80/2015 është Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. UGJ-ja periodikisht ka kaluar proceset e akreditimit me Vendim Nr.67, datë 21.09.2017 dhe Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL-it. Referuar certifikatës së akreditimit, UGJ-ja është akredituar si institucion me 4 vjet.</i> <i>GVJ konstatoi se Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe të Kurrikulave zbaton procedurat dhe urdhrat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, por nuk harton politika dhe nuk ka kompetenca për miratimin e instrumentave matëse të procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit të stafit akademik. Po ashtu, GVJ gjykon se sondazhet apo pyetësorët, si instrumenta matëse dhe vlerësuese të mirëfillta të cilësisë së mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike, duhet të jenë më të shpeshtë, më të mirëstrukturuar, duke garantuar kështu një pjesëmarrje më gjithëpërfshirëse dhe duke mundësuar gjenerim më të saktë, të qartë e të plotë të të dhënave të grumbulluara. Përpunimi më i drejtë i të dhënave do të çonte në identifikimin e problematikave dhe hartimin e politikave dhe praktikave të duhura për zgjidhjen e tyre dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe aktivitetit kërkimor-shkencor.</i> <i>GVJ rekomandon që të riorganizohet puna dhe të bëhen më të efektshme rezultatet e pritshme nga sektori dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë së mësimdhënies dhe veprimtarisë</i>



	shkencore në UGJ. Kështu, UGJ-ja duhet të hartojë dhe të zbatojë strategji institucionale për cilësinë si dhe të miratojë instrumenta të unifikuar matës për garantimin e standardeve të cilësisë në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin mbështetës, vërejmë se UGJ-ja përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetësorët apo anketimet e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike procesit mësimor dhe kërkimit shkencor në nivel departamenti, fakulteti dhe atë institucional. Megjithatë, gjykojmë si jo të mjaftueshëm realizimin e vetëm dy pyetësorëve: ai i procesit të mësimit online dhe ai i sondazhit kombëtar të studentëve. Sipas akteve ligjore dhe nën-ligjore në fuqi, zhvillimi i pyetësorëve duhet të jetë periodik, në dobi të akreditimit të programit të studimit duke evidentuar në mënyrë efikase pikat e forta dhe dobësitë e të gjitha elementeve përbërëse të programit të studimit. Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së 2021-2022; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore – shkencore të NJBGJSH-SË, 2021-2-22; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore –shkencore të NJBL-SË, 2021-2-22); ANEKS-Tabela përmbledhëse. Tabela 11; Evidenca 3.16.1. Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online; Evidenca 6.5. Sondazhi kombëtar i studentëve.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme,	Referuar dokumentacionit mbështetës në DVV dhe bashkëbisedimit me stafin akademik, konstatojmë se institucioni harton raportet vjetore institucionale dhe raportet e vlerësimit të



rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	cilësisë, duke u mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këto raporte hartohen periodikisht dhe funksionojnë në nivel departamentesh, fakulteti dhe universiteti. Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së 2021-2022; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të NJBGJSH-SË, 2021-2-22; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të NJBL-SË, 2021-2-22.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Referuar dokumentacionit mbështetës në DVV dhe vizitave në institucion, vërejmë se institucioni harton raportet vjetore institucionale dhe raportet e vlerësimit të cilësisë, duke u mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këto raporte hartohen periodikisht dhe funksionojnë në nivel departamentesh, fakulteti dhe universiteti. Po ashtu, SSCK-ja harton Raport vjetor mbi vlerësimin e cilësisë dhe i bën ato publike. Mbikqyrja dhe monitorimi i programeve të mësimdhënies, kërkimi shkencore dhe veprimtari të tjera realizohen nga dy Njësitë Bazë përgjegjëse për programin e studimit në fjalë. Evidenca 6.6. Raport vjetor i sektorit të Standardeve dhe kurrikulave për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 6.7. Raport vjetor i sektorit të Standardeve dhe kurrikulave për vitin akademik 2021-2022; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022; Evidenca 4.1. Raporti vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të FESHSH-së 2021-2022; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore -shkencore të NJBGJSH-SË, 2021-2-22; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të NJBL-SË, 2021-2022.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e	Referuar RVB-së, evidencave plotësuese, konstatohet se UGJ-ja përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, (të atyre të diplomuar, të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ. Të dhënat e mësipërme faktohen në evidencat e poshtëshënuara. Evidenca 3.16. Urdhër nr. 16., datë 25.3.2022, Për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë; Evidenca 6.5. Sondazhi kombëtar; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23); Evidenca 3.21.



institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022; Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023. Gjykojmë se metodat e tërthorta të vlerësimit të përdorura si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program nuk janë të mjaftueshme, plotësisht efikase dhe shteruese. GVJ-ja rekomandon që në të ardhmen organizmat përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të jenë më të angazhuara në proces duke garantuar cilësi dhe efikasitet.
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se UGJ-ja zbaton një procedurë të formalizuar e të dokumentuar pjesërisht përsa i përket kuadrit rregullator për shqyrtim dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit. FESHSH-ja/NJBGJSH-ja dhe NJBL-ja hartojnë Raportet Vjetore në të cilin vlerësohet mbarëvajtja e programeve të studimit. Njësitë bazë përgjegjëse përmirësojnë kurrikulën e programeve të studimit që ofron.</i> <i>Gjith ashtu, SSCK-ja harton Raport vjetor mbi vlerësimin e cilësisë dhe i bën ato publike. Po ashtu, GVJ-ja konstaton se janë zhvilluar vetëm dy pyetësorë, ai i procesit të mësimi online dhe ai i sondazhit kombëtar të studentëve, të cilët GVJ-ja i gjykon si jo të mjaftueshmë.</i> <i>Sipas akteve ligjore dhe nën-ligjore në fuqi, zhvillimi i pyetësorëve duhet të jetë periodik në dobi të akreditimit të programit të studimit duke evidentuar në mënyrë efikase pikat e forta dhe dobësitë e të gjitha elementeve përbërëse të programit të studimit. Për më tepër, duke qenë të realizuar në nivel institucional, këto pyetësorë nuk përmbajnë të dhëna konkrete për cilësinë dhe mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe aktivitetin kërkimor shkencor të programit të studimit Bachelor në Gjuhë-Letërsi shqipe.</i> <i>Për më tepër, nga vizita në institucion, GVJ-ja vëren se UGJ ka hartuar një Manual të Cilësisë për institucionin që përmban edhe mekanizmat dhe instrumentat matës së cilësisë në programet e studimit. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët nuk janë të mjaftueshme, plotësisht efikase dhe shteruese.</i>



	GVJ-ja rekomandon që në të ardhmen organizmat përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të jenë më të angazhuara në proces duke garantuar cilësi dhe efikasitet. Gjithashtu, lipset të hartohet një plan masash të ndërmarra praktikisht në funksion të vështirësive dhe mangësive që mund të jenë evidentuar nga sondazhet duke adresuar zgjidhjen e problemeve dhe sigurimin e cilësisë në të ardhmen. Krijimi i grupit të përhershëm të vlerësimit të brendshëm, që monitoron dhe vlerëson më nga afër, në mënyrë të vijueshme, programin e studimit dhe harton raporte për cilësinë e tij në rang fakulteti është domosdoshmëri në kuadër të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të përfshirë në DVV, dy janë strukturat përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ-së: Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Gjithashtu, konstatojmë zyra e Alumni, Keshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar pranë UGJ-së është pjesëmarrëse dhe promovuese e programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. Evidenca 3.21. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022; Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023; Evidenca 1.18. Struktura organizatibë e UGJ-së; Evidenca 6.2. Rregullore e NJSBC-së, neni 3; Evidenca 6.8. Manuali i cilësisë në UGJ; Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 94, pika 2. Praktikisht, nga vizita dhe bashkëbisedimet në institucion, rezulton se NJSBC –ja është një njësi e re, e cila është në

	strukturim e sipër, dhe si e tillë lipset të sigurohet mirëfunksionimi i saj dhe përmbushja e të gjitha detyrimeve dhe funksionimit me efikasitet i saj për garantimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjykojmë se është i nevojshëm zbatimi praktik i elementeve dhe ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në dobi në sigurimit të cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe". Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", neni 94; Evidenca 4.8 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e DSHNA-së, nenet 12,13; Evidenca 6.2. Rregullore e NJSBC-së; Evidenca 6.6. Raport vjetor i sektorit të Standardeve dhe kurrikulave për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 6.7. Raport vjetor i sektorit të Standardeve dhe kurrikulave për vitin akademik 2021-2022; Evidenca 1.7. Rregullore e UGJ-së; Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSH-së; Evidenca 2.12. Rregullore e NJBGJSH-së dhe NJBL-së; Evidenca 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Sipas dokumentacionit mbështetës në DVV dhe analizës së bërë në RVB, vërehet se njësitë bazë ngrejnë njësinë e sigurimit të cilësisë së brendshme, në të cilën përfshihen anëtarët e njësisë bazë dhe të paktën 1 (një) student. GVJ gjykon se njësitë bazë e kryesore përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët duhet të jenë praktikisht më të përfshirë dhe të angazhuar në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Evidenca 5.24.1 Vendimi nr.2 i NJB-ve Për miratimin e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe".
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentacionin mbështetës në DVV, GVJ konstaton Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UGJ. Evidenca 3.19 Kodi i Etikës; Evidenca 4.12. Rregullore per mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Evidenca 1.1. Statuti i UGJ-së, neni 6.

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar në informacionin e përçuar në RVB dhe dokumentacionin mbështetës në DVV, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës marrin pjesë në panairë që mund t'u shërbejnë studentëve për një qasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe intershipi. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të bëra në kuadër të promovimit dhe përmirësimit dhe sigurimit të cilësië, një pjesë e konsiderueshme e marrëveshjeve institucionale mbetet vetëm në letër dhe e pazbatuar realisht. Evidenca 3.21. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022; Evidenca 3.22. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se në UGJ janë ngritur Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), të cilat struktura përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ-së. Megjithatë, GVB-ja gjykon se është i nevojshëm zbatimi praktik dhe ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në dobi në sigurimit të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Gjuhë-Letërsi shqipe. GVJ rekomandon se njësitë bazë e kryesore përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët mund të jenë praktikisht më të përfshirë dhe të angazhuar në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Pavarësisht përpjekjeve të bëra në kuadër të promovimit dhe përmirësimit dhe sigurimit të cilësië, GVJ vëren se një pjesë e konsiderueshme e marrëveshjeve institucionale mbetet vetëm në letër dhe e pazbatuar realisht. Po ashtu, GVJ gjykon se në rang fakulteti e njësie bazë, duhej të ishte ngritur Grupi i përhershëm i vlerësimit të brendshëm, që monitoron dhe vlerëson më nga afër, në mënyrë të vijueshme, programin e studimit dhe harton raporte për cilësinë e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5


Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Referuar dokumentacionit mbështetës në DVV, konstatohet se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit nëpërmjet faqes zyrtare web dhe programit të transparencës [https://uogj.edu.al/transparenca/]. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit, Raportet etj, gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, studentët etj.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në RVB dhe në evidencat e përpiluara nga GVB, po ashtu edhe nga vizita nga institucion vërejmë se në hartimin e raporteve, NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 9887/10.03.2008 ndryshuar me ligjin 48/2012). Raportet u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike. Evidenca 3.16. Urdhër nr. 16, datë 25.3.2021, Për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë; Evidenca 3.16.1. Raport i pyetësorit për procedurën e mësimit online; Evidenca 6.5. Sondazhi kombëtar; Evidenca 4.12. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; Evidenca 3.19. Kodi i Etikës dhe vendimi i miratimit të kodit.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pasi shqyrtoi dokumentacionin mbështetës, konstatohet se rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit, dekanatit dhe departamenteve. Në analizën e saj, NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike. Gjykojmë që këto raporte krahas rezultateve të kenë edhe më shumë rekomandime apo adresim të problematikave të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Referuar RVB-së dhe të dhënave përkatëse, institucioni në kuadër të akreditimit institucional, ka marrë disa rekomandime për përmirësimin e cilësisë së punës dhe ofrimit të shërbimeve, sugjerime dhe kërkesa këto që institucioni po përpiqet të plotësojë. GVJ rekomandon që aktiviteti dhe funksioni i NJSBC-së në monitorimin e vlerësimit të cilësisë në përmirësim në vijim



	të cilësisë së programit të studimit të jetë më mirë i organizuar, më i plotë dhe i shpeshtë. Evidenca 6.9. Plan i veprimit për Akreditimin institucional periodik; Evidenca 6.10. Vendimi nr. 15.3.6.2022 i Senatit Akademik për miratimin e planit të veprimit; Evidenca 6.6. Raport vjetor i sektorit të standardeve dhe kurrikulave për vitin 2020-2021; Evidenca 6.7. Raport vjetor i sektorit të standardeve dhe kurrikulave për vitin 2021-2022; Evidenca 1.17. Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2021-2022, Evidenca 4.1. Raporti i veprimtarisë mësimore - shkencore të FESHSH-së 2021-2022; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të njësisë bazë të gjuhës shqipe për vitin 2021-2022; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të njësisë bazë të Letërsisë 2021-2022; Evidenca VI.6 Raport vlerësimi të cilësisë viti 1; Evidenca VI.6.1 Raport vlerësimi të cilësisë viti 2.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në RVB dhe në evidencat e përpunuara nga GVB, gjykojmë se UGJ-ja duhet të zhvillojë më shumë aktivitete me studentët dhe stafin akademik për informimin, aftësimin e tyre në profesionin e tyre (të ardhshëm), aktivitete kërkimore shkencore, konferenca shkencore e studentëve dhe stafit akademik në funksion të sigurimit dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Evidenca 3.16. Urdhër nr. 16, datë 25.3.2021, Për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë; Evidenca 3.16.1. Raport i pyetësorit për procedurën e mësimin online; Evidenca 6.5 Sondazhi kombëtar; Evidenca 1.22. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të njësisë bazë të gjuhës shqipe për vitin 2021-2022; Evidenca 1.23. Informacion vjetor për veprimtarinë mësimore-shkencore të njësisë bazë të Letërsisë 2021-2022.
Konkluzione	<i>Pasi shqyrtoi dokumentacionin mbështetës në DVV dhe pas vizitave institucionale, GVJ konstaton se në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UGJ-ja bën publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit mekanizmat kontrollues dhe monitories në faqen zyrtare web në kuadër të programit të transparencës [https://uogj.edu.al/transparenca/].</i> <i>NJSBC-ja vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të UGJ-së e për këtë harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm ku adresohen pikat e forta dhe të dobëta, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. GVJ</i>



	<i>gjykon që aktiviteti dhe funksioni i NJSBC-së në monitorimin e vlerësimit të cilësisë në përmirësim në vijim të cilësisë së programit të studimit të jetë më mirë i organizuar, më i plotë dhe i shpeshtë. Gjithashtu,</i> <i>GVJ gjykon si të domosdoshme ngritjen e Grupit të përhershëm të vlerësimit të brendshëm, në rang fakulteti. Ky organizim do të ketë rol të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin periodik të programit të studimit duke hartuar edhe raporte për cilësinë e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Egerem Çabej” i Gjirokastrës.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit trashëgon eksperiencën e programit tradicional. Ka vazhdimësi në programin e ciklit të dytë dhe ka përputhje të plotë me fushën akademike së cilës i përket.
2. Staf i akademik zotëron kompetencat e nevojshme dhe ka kualifikim të mirë akademik.
3. Struktura përgjegjëse për realizimin e programit bën përpjekje për përmirësimin e kurrikulës me nevojat dinamike të tregut të punës.

Pika të dobëta:

1. Universitet e tjera brenda vendit ofrojnë programe të njëjta/ të ngjashme studimi që mund të ndikojnë në uljen e ndjeshme të numrit të studentëve. (Standardi V.5, kriteri 5)
2. Konkurrencë e fortë nga programe të tjera studimi, më të pëlqyeshme midis të rinjve, të ofruara nga vetë Universiteti i Gjirokastrës. (Standardi V.4, kriteri II)
3. Mungesa e përfshirjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. (Standardi III.1, kriteri 6), si dhe numri i ulët i mobiliteteve.

Rekomandime:

1. Të bëhet një punë më vizionare në kuadër të zgjerimit të kompetencës së programit të studimit përkatës me synim zgjerimin e korpusit referues. Për këtë mund të ndryshojë emërtimi në “Gjuhësi dhe letërsi”.
2. Reflektimin e zgjerimit të kompetencës dhe korpusit referues më sipër me sillabuse koherente me ato botërore dhe manuale të detyrueshme dhe fakultative për t’u konsultuar përsëri të përvojës së huaj.
3. Rifreskim të sillabuseve dhe literaturave që t’i përkasë dhjetë viteve të fundit, në kuadër të krijimit të një kompetence koherente me përvojat e përparuara europiane e jo vetëm.
4. Në kontekstin e sugjerimeve më lart mund të këshillojmë shfrytëzimin e kapaciteteve akademike të departamenteve të tjera (Departamenti i Gjuhëve të Huaja), duke pasur parasysh se ata e kanë kompetencën në lëndë të caktuara me korpus më të gjerë se shqipja. Kjo gjë do të plotësonte mungesën e rekrutimit të stafit akademik në Departamentin e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.
5. Rritjen e numrit të mobiliteteve afatgjata në kuadrin e trajnimit për stafin akademik dhe studentët. Është domosdoshmëri një sugjerim i tillë, pasi do të shtonte individualitetet akademike që do të kontribuonin në individualitete të pajisura me kompetenca kurrikulare, të cilat do të profilizonin ciklin e studimit.
6. Rritjen e efektivitetit të laboratorëve didaktikë-shkencorë në përgjithësi dhe funksionalizimin e pajisjeve moderne që egzistojnë në disa prej këtyre laboratorëve në veçanti. Shtimin e të tjerave veç atyre që ekzistojnë.



7. Zgjerimin e kontakteve me institucione publike e jo publike, biznese, në funksion të zgjerimit të mundësive për aftësim të vazhdueshëm të studentëve, përditësimin dhe përmirësimin e studimeve për tregun e punës. Edhe ato kontakte që janë tashmë të realizuara të monitorohen me vizion se si po aplikohen apo si mund të aplikohen në të mirë të universitetit dhe të studentëve.
8. Bashkëpunim më të thelluar me departamentet simotra në universitete në të gjithë hapësirën shqipfolëse, si dhe me katedrat e albanologjisë jashtë vendit. Aplikimi i përvojës së lektorëve të ftuar për disa cikle leksionesh, në mënyrë që të krijohen standardet e duhura të krahasimit metodologjik e veçanërisht të rezultateve individuale të personaliteteve të fushës.
9. Të punohet për ndërkombëtarizimin e departamentit, për të integruar dhe shfrytëzuar me dinamizëm kapacitet akademike, si dhe për kontakte në përputhje me zhvillimin e rajonit dhe me elemente të globale me rikonceptim dhe rivlerësim të vlerave tona kombëtare.
10. Të shtojë përpjekjet për hapjen e programeve të përbashkëta me universitete të huaja, në dobi të prirjeve bashkëkohore që arsimi i lartë ka sot në Republikën e Shqipërisë, për zhvillime të reja dhe konkrete, për mundësi zhvillimi dhe rritjen e ofertës së punësimit për studentëve.
11. Të përshtaten kurrikulat në varësi të kërkesave rajonale të tregut të punës, pasi njëtrajtshmëria e këtyre kurrikulave me universitetet e tjera shqiptare e minon procesin e rekrutimit të studentëve.
12. Të aplikohet korigjimi i një pjese të konsiderueshme të pyetjeve të tezave të provimit me CLEANSORE, në mënyrë që të rritet transparenca dhe objektiviteti në vlerësim.
13. Të shikohet mundësia e ngritjes së një bordi këshillimor me partnerë strategjikë për tregun e punës në nivel fakulteti.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Albanian language and literature" provided by the Higher Education Institution University of Gjirokastra "Egerem Çabej"

Strengths and affirmations

1. The study program inherits the experience of the traditional program. There is continuity in the second cycle program and it is fully compatible with the academic field to which it belongs.
2. The academic staff possesses the necessary teaching skills, academic competencies, and qualifications.
3. The structure responsible for the implementation of the program makes continuous efforts to improve the curriculum following the dynamic needs of the labor market.



Weaknesses

1. **Other universities within the country offer the same/similar study programs that may affect the significant decrease in the number of students. (Standard V.5, criterion 5)**
2. **Strong competition from other study programs, more popular among young people, offered by the University of Gjirokastra itself. (Standard V.4, criterion II)**
3. **Lack of involvement in national and international projects. (Standard III.1, criterion 6), as well as the low number of mobilities.**

Recommendations

1. **It is recommended that both departments conduct some more visionary work within the scope of expanding the competence of the relevant study program and the aim of expanding the reference corpus. For this reason, the name of the study program can be changed to "Linguistics and Literature".**
2. **The expansion of the reference corpus above should be reflected upon coherent syllabuses following the international mandatory and optional manuals.**
3. **In the context of the suggestions above, we can advise the use of the academic capacities of other departments (the department of foreign languages), considering that they have competence in certain subjects with a wider corpus than Albanian. This would fill the lack of academic staff recruitment in the Department of Albanian Language and Literature.**
4. **Increasing the number of short and long-term learning, teaching, and training mobilities for both the academic staff and students. Such a suggestion is necessary, as it would further elaborate the academic individuality of the study cycle profile.**
5. **Increasing the effectiveness of didactic-scientific laboratories in general and the functionalization of modern equipment that exists in some of these laboratories in particular.**
6. **Developing further contacts with public and non-public institutions, and businesses, to expand opportunities for continuous training of students, updating and improving studies for the labor market. Even those contacts that have already been made should be monitored on the way they are being applied or how they can be applied for the benefit of the university and the students.**
7. **Establishing broader cooperation with sister departments in universities throughout the Albanian-speaking area, as well as with Albanianology departments abroad. Guest lecturers' experiences for several cycles of lectures would serve to create the appropriate standards for methodological comparison in different disciplines.**
8. **Working for the internationalization of the department, to integrate and dynamically utilize academic capacity, as well as establishing contacts following the development of the region and with elements of the global and national values.**



9. **Increasing efforts to open joint programs with foreign universities, for the benefit of the contemporary trends that higher education has today in the Republic of Albania, for new and concrete developments, for development opportunities, and for increasing the employment offer for students.**
10. **Considering the possibility of setting up an advisory board with strategic partners for the labor market at the faculty level.**
11. **Adapting the curricula to the regional requirements of the labor market, since the compatibility of these curricula with other Albanian universities undermines the process of recruiting students.**



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	